

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

Studimet pasdiplomike-cikli i dytë

Tezë Masteri

“Disa masa parandaluese të veprës penale të korrupsionit”

Kandidatja:

Besa Azizi

Mentor:

Doc. Dr. Ismail Zejneli

Tetovë, 2020

Deklarata e origjinalitetit

Unë, Besa Azizi, me përgjegjësin time më të lartë deklaroj që ky punim me titull **“DISA MASA PARANDALUESE TË VEPRËS PENALE TË KORRUPSIONIT”** përfaqëson punimin tim origjinal, është shkruar prej meje, përveç rasteve të citateve dhe referencave të tjera. Ky punim nuk është përdorur më parë në këtë Universitet dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim.

Besa Azizi

Tetovë, 2020

Mirënjohje dhe falënderime

Unë do të doja të shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e mia mentorit tim Doc. Dr. Ismail Zejneli që më ka këshilluar, udhëzuar, motivuar dhe që më ka mbështetur gjatë gjithë kohës së këtij hulumtimi, duke bërë kështu të mundur që të përfundojë këtë tezë me sukses.

Gjithashtu, mirënjohje dhe respekt i veçantë për pedagogët e tjerë të Fakultetit të Drejtësisë të SEEU-së, për të gjitha idetë, këshillat dhe sugjerimet e tyre të vlefshme në realizimin e punimit të magjistraturës mbi korrupsionin.

Dhe së fundmi, falënderimi më i rëndësishëm shkon për familjen time veçanërisht prindërit e mi, të cilëve u jam shumë mirënjohëse për përkrahjen e pakursyer gjatë gjithë viteve të studimeve të mia pa ndihmën e të cilëve nuk do të arrija deri këtu.

Abstrakt

Korrupsioni si fenomen është i përhapur prej që egziston njerëzimi apo siç është treguar në disa literatura që ai egziston prej kur është formuar edhe vetë shteti. Dhe ky fenomen është i pranishëm pothuajse në të gjitha institucionet nga ato më të ulta në ato më të lartat, apo thënë ndryshe ai përfshinë të gjitha organet shtetërore dhe shoqërinë, duke filluar nga një punëtorë i thjesht deri tek një zyrtarë me pozicion të lartë.

Prandaj dhe duke patur parasysh se korrupsioni sot është një fenomen shumë i përhapur nëpër të gjitha vendet e botës dhe ka prekur të gjitha organet shtetërore dhe shoqërinë në tërësi, vendosa që studimi im të paraqet një pasqyrë të korrupsionit për vendin tonë Maqedoninë e Veriut.

Studimi trajton si fillim një përshkrim rreth fenomenit të korrupsionit, karakteristikat e tij dhe shkaqet që çojnë deri te ai, pastaj tregon për korrupsionin në Maqedoninë e Veriut, se si është shkalla e mitëdhënies dhe mitëmarrjes në vend duke i shfaqë edhe kodet penale për kryerjen e këtyre veprave penale dhe më pas puna jonë i kushtohet luftës kundër akteve korruptive dhe masat që duhet të ndërmerren deri te reduktimi i tij.

Fjalët kyçe: Korrupsioni, vendi, Maqedonia e Veriut, kodi penal.

Abstract

Corruption as a phenomenon is widespread since the existence of humanity or as it has been shown in some literatures that it has existed since the formation of the state itself. And this phenomenon is present in almost all institutions from the lowest to the highest, or in other words it involves all state bodies and society from a simple worker to a high-ranking official.

Therefore, given that corruption today is a very widespread phenomenon in all countries of the world and has affected all state bodies and society as a whole, I decided that my study will represent an overview of corruption for our country North Macedonia.

The study first deals with a description of the phenomenon of corruption, its characteristics and causes leading to it, then shows the corruption in North Macedonia, what is the rate of bribery in the country, showing the criminal codes for committing these criminal offenses and then our work is dedicated to the fight against corrupt acts and the measures that must be taken to reduce it.

Keywords: Corruption, country, North Macedonia, criminal code.

Абстракт

Корупцијата како феномен е широко распространета уште од постоењето на хуманост или како што е прикажено во некои литератури што таа постои од формирањето на самата држава. Овој феномен е присутен во скоро на сите институции од најнизок до највисок, или да кажеме со други зборови ги вклучува сите државни тела и општество, почнувајќи од едноставен работник до висок функционер.

Затоа и со оглед на тоа што корупцијата денес е многу распространета појава во сите земји во светот и ги зафати сите државни тела и општеството како целина, решив да мојата студија претставува преглед на корупцијата за нашата земја Северна Македонија.

Студијата најпрво се занимава со опис на феноменот на корупција, неговите карактеристики и причини што доведуваат до него, потоа се покажува корупцијата во Северна Македонија, како е стапката на давање и примање поткуп во земјава, покажувајќи ги кривични закони за сторено овие кривични дела, а потоа нашата работа е посветена на борбата против корумпираните дејствија и мерките што мора да се преземат за да се намалат.

Клучни зборови: корупција, земја, Северна Македонија, кривичен закон.

Përmbajtja

Deklarata e originalitetit.....	2
Mirënjohje dhe falënderime.....	3
Abstrakt	4
Abstract	5
Абстракт	6
Përmbajtja	7
Lista e tabelave	9
Lista e figurave	10
Hyrje	11
Rëndësia e studimit.....	12
Objektivat e studimit.....	12
Definimi i problemit	13
Kreu I	14
1. Kuptimi (nocioni) i korrupsionit	14
2. Korrupsioni dhe evoluimi historik i tij	16
3. Karakteristikat e korrupsionit	17
4. Aspekte komparative të korrupsionit.....	18
4.1 Krahësim me R. Kosovës	18
4.2 Krahësim me R. Shqipërisë	20
Kreu II	23
1. Aspekte Juridiko-penale të korrupsionit	23
2. Aspekte sociologjike të korrupsionit	25
3. Ndryshimet sociale dhe korrupsioni.....	26
4. Shkaqet e paraqitjes së korrupsionit.....	27
5. Korrupsioni si pengesë e shoqërisë.....	32
5.1 Korrupsioni si pengesë e zhvillimit të reformave në shoqëri	32
5.2 Korrupsioni i “jakave të bardha,” kërcënim për shtetin e së drejtës në RMV-ut ..	33
Kreu III	39
1. Ndërkombëtarizimi i korrupsionit.....	39
2. Korrupsioni si pengesë për integrimin e RMV në BE.....	40
3. Harmonizimi i legjislacionit të RMV me të drejtën e BE.....	41
4. Korrupsioni në Maqedoni	42
5. Dhënia e mitos	48
6. Marrja e mitos.....	52

Kreu IV	56
1. Masat parandaluese të korrupsionit	56
2. Problemet e zbulimit të korrupsionit	59
3. Bashkëpunimi rajonal në luftën kundër korrupsionit	59
4. Korniza juridiko ndërkombëtare e luftës kundër korrupsionit	61
Përfundime dhe rekomandime	64
Rekomandimet	65
Kufizimet e punimit dhe sugjerimet për të ardhmen	65
Referencat	67
Shtojcat	70
Shtojca 1 Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2019: Rezultati Global	70
Shtojca 2 Numri i personave të shpallur fajtor për kryerjen e të gjitha llojeve të krimeve për periudhën 2010-2019	75

Lista e tabelave

Tabela 1. Radhitja e vendeve të rajonit sipas transparencës përmes indeksit të perceptimit të korrupsionit	20
Tabela 2. Radhitja dhe indeksi i korrupsionit për Shqipërinë dhe Kosovën për periudhën 2010-2019.....	22
Tabela 3. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit në Maqedoni.....	43
Tabela 4. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për vendet e Ballkanit perëndimor	44
Tabela 5. Personat e raportuar dhe të dënuar për të gjitha llojet e krimeve në RMV për periudhën 2010-2019.....	45
Tabela 6. Perceptimi qytetarëve për përhapjen e korrupsionit nëpër profesione	46

Lista e figurave

Figura 1. Numri i personave të shpallur fajtor për shpërdorim detyre për periudhën 2010-2019.....	38
Figura 2. Perceptimi i korrupsionit në profesione - më të korrupsionuarit	47
Figura 3. Dhënia e mitos në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019	50
Figura 4. Numri i personave të shpallur fajtor për mitëdhënie dhe mitëmarrje për periudhën 2010-2018.....	51
Figura 5. Marrja e mitos në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019.....	53
Figura 6. Marrja e mitos në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitet 2014, 2016 dhe 2019 .	54

Hyrje

Për sa i përket korrupsionit është vështirë të thuhet një definicion i saktë pasi është një dukuri shumëdimensionale dhe egzistojnë definicione të ndryshme për të, por që ai është i përhapur që nga kohët e lashta dhe njihet që kur është shfaqur njerëzimi. Si një nocion të përgjithshëm mund të thuhet që ai ka të bëjë me përfitimet personale të një njeriu, i cili për të kryer një shërbim dëmton një person tjetër duke i kërkuar diçka në këmbim, prandaj dhe thuhet që ky fenomen është një ndër dukurit negative që e cenojnë shtetin.

Korrupsioni sot është një fenomen shumë i përhapur nëpër të gjitha vendet e botës pra paraqet një problem global por që ai dallon nga vendi në vend sipas formës dhe shkaqeve të paraqitjes së tij, ai paraqet një kërcënim të madhë për një shoqëri të zhvilluar dhe për sistemin juridik të një vendi.

Korrupsioni është një kërcënim si për vendet e pasura ashtu edhe për vendet e varfëra, por më shumë nga ky fenomen janë të prekur vendet në tranzicion apo vendet në zhvillim. Korrupsioni ndodhë në të gjithë sektorët e komunitetit ashtu si në sektorin publik edhe në atë privat dhe kjo bënë që qytetarët të humbin besimin tek shteti dhe tek të drejtat e tyre. Mirëpo ai më së shumti ndodhë në sektorin publik, në vende si: spitale, gjyqe, dogana, politika e kështu me rradhë, dhe nga kjo shohim shumë qartë që ai përfshihet gati se në të gjitha vendet apo institucionet e vendit, prandaj dhe kjo paraqet rrezik ose ndryshe është në dëm të shoqërisë. Kështu që është shumë e nevojshme që të hulumtohen mirë këto vepra penale me qëllim që të mbrohet shoqëria poashtu edhe shteti.

Prandaj dhe nga e gjitha kjo që u tha si arsyeje kryesore se pse zgjedha që të trajtojë këtë temë është se krimi i korrupsionit sidomos ai i kryer nga ana e zyrtarëve po gjeneron shumë dëme për qeverinë tonë dhe për shoqërinë tonë dhe pasi është një temë shumë aktuale në vendin tonë dhe çdo ditë shkruhet në media për to, vendosa që nëpërmjet këtij punimi të mund të ndihmojë që të e kuptojmë dhe të e shqyrtojmë mirë këtë problematikë.

Në këtë punim do të hulumtojmë rreth korrupsionit, konkretisht rreth asaj se cilët janë shkaqet e paraqitjes së tij, çfarë pasojash shkaktojnë këto vepra penale, gjithashtu do të analizojmë se cilët vende janë prekur më së shumti ndaj këtyre veprave penale të korrupsionit në fokus të veçantë për Maqedoninë e Veriut dhe në fund tregojmë për masat

që duhet të ndërmerren me qëllim që të mund të e minimizojmë atë, pasi që për të e eliminuar totalisht është disi e pamundur.

Rëndësia e studimit

Në këtë punim janë paraqitur veprat penale kundër korrupsionit, të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar duke u referuar te parashikimet e Kodit Penal të vendit që lidhet me këto vepra penale.

Kur një vend ka një qeverisje të mirë nënkuptojmë që nuk ka abuzim të pushtetit të shtetit dhe që ai vend zbaton mirë ligjin, ndërsa kur në një vend ka përfshirje të korrupsionit dhe e ka të vështirë të e kontrollojë atë, atëherë ai do të shkatërroj një qeverisje të mirë të vendit dhe do të rezultojë në dështim të institucioneve shtetërore.

Korrupsioni, me pakë fjalë, është një dukuri që dëmton legjitimitetin e qeverisë, çënon të drejtat e njeriut dhe që me kryerjen e kësaj vepre penale nuk respektohen ligjet e së drejtës së shtetit. Kështu që, përmes hulumtimit tonë mbi korrupsionin ne dëshirojmë që të nxjerrim në pah, të identifikojmë ato ndikime negative të cilat na dërgojnë në një gjendje jo të shëndetshme dhe që të kontribuojmë në një zgjidhje apo lehtësim të këtij problemi që e prek shoqërinë në tërësi.

Si një ndër qëllimet kryesore të këtij studimi është që nga rezultatet e hetimit të mund të ndihmojmë në vendosjen e mjeteve të reja për luftën kundër korrupsionit, në njëfarë mënyre të propozojmë zgjidhje reale në luftën kundër kësaj goditje që po bën shumë dëmtime ndaj shoqërisë.

Objektivat e studimit

Çdo ditë ne shohim e ndëgjojmë lajme nga më të ndryshme si ato të përgjithëshme dhe ato rreth vendit, nga të cilat shpesh tregohet edhe për vepra penale të korrupsionit që janë kryer nga zyrtarë të vendit dhe kjo na bënë të kuptojmë që këto vepra gjithnjë e më shumë rriten dhe kjo shfaqë një shqetësim të madhë për shoqërinë.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të shqyrtojmë korrupsionin, të shohim se ku është më shumë i pranishëm në cilin sektorë, të tregojmë se cilët janë arsyet që shkaktohen këto vepra penale dhe të tregojmë masat që duhet të ndërmerren apo të propozojmë mjete të cilat do të ishin të nevojshme për të minimizuar apo për të zvogluar këtë dukuri në vendin tonë.

Definimi i problemit

Si një ndër problemet kryesore në vendit tonë është se shumë raste të paraqitura në gjykatë për kryerje të krimit të korrupsionit janë tërhequr si pasojë e asaj se nuk ka prova të mjaftueshme për të akuzuar dikë, të cilat krime janë kryer nga zyrtarë të lartë publik, por që përshkak pozicionit që kanë është edhe shumë vështirë për tu akuzuar.

Korrupsioni është një dukuri që ndikon negativisht në demokracinë e vendit, në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në veçanti në mirëqenien e qytetarëve, kështu që duke qenë se kjo është e lidhur me moralin publik, paraqet dëm shumë të madhë dhe shfaqë efekte shkatërruese në besimin e qytetarëve që duhet të kenë ato në institucionet e shtetit, prandaj dhe është e nevojshme të studjohen mirë këto vepra ashtu që të mund t'i luftojmë këto vepra penale.

Këtu në këtë punim ne do të përpiqemi të propozojmë disa masa që tregojnë se si të parandalojmë këtë dukuri për të cilat ndoshta edhe keni sadopak njohuri por që nuk janë vënë në praktikë, prandaj duhet që të mundohemi që këto propozime të shkojnë në vend në menyrë që të na ndihmojnë në luftimin e akteve të korrupsionit dhe që nëpërmjet standardeve adekuate të mund të kontrollojmë ato.

Kreu I

1. Kuptimi (nocioni) i korrupsionit

Fjala “korrupsion,, e ka origjinën nga latinishtja “corrumpere,, që do të thotë *thyej, shkatërroj apo dëmtoj*. Dhe sipas kësaj kuptojmë që akti korruptiv e thyen ligjin, detyrat dhe normat morale. Disa definicione të rëndësishme që lidhen me korrupsionin janë ato si; ai i Bankës Botërore që thotë se: “Korrupsioni është përdorimi i paligjshëm i burimeve publike për përfitim personal,,¹

Transparency International gjithashtu për korrupsionin thot që: “Korrupsioni është abuzimi i pushtetit e besuar për përfitime private,,²

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) korrupsionin e përkufizon si: “Shpërdorim i detyrës së pushtetit publik ose autoritetit për përfitime private - nëpërmjet mitës, shpërdorimit të detyrës, tregitimit të influencës, nepotizmit, mashtrimit, parave për përshpejtim ose abuzimit me fondet,,³

Sipas fjalorit Juridik Black një përkufizim i gjerë mbi korrupsionin është : “Akti i një zyrtari ose personi kujdestar që në mënyrë të paligjësme ose të gabuar përdor pozicionin ose karakterin e tij për të nxjerrë përfitim për vete ose për një person tjetër, në kundërshtim me detyrën dhe të drejtat e të tjerëve,,⁴

Njerëzit pajtohen me atë që korrupsioni është një dukuri e keqe, por që për të nuk ka një definicion të saktë, pasi që egzistonë një literaturë e gjerë me definicione të ndryshme rreth tij, ku kemi definicione të ashtuquajtura “definicione formale,, që janë ato kanë të bëjnë me legjislacionin, qeverinë dhe kodet e sjelljes. Dhe kemi “definicionet sociale,, që për të treguar se çfarë është korrupsioni varet nga komuniteti dhe nga vendi i punës. Dhe këto dy lloje të definicioneve shpesh nuk korrespondojnë njëra me tjetrën.⁵

Korrupsioni si term është shumë i gjerë në kuptimin e tij, ky term ka shumë sinonime si: dekompozim, sëmundje, imperfeksion, degjenerim, mashtrim, ves, e të tjera. Por çfarëdo qoftë kuptimi i termeve sipas fjalorit, ai është kryesisht i lidhur me dështimin e

¹ Cristi Danilet “Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë”, Tiranë, 2011, fq. 14-15.

² Transparency International - <https://www.transparency.org/ëhat-is-corruption>

³ Cristi Danilet “Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë”, Tiranë, 2011, fq.16.

⁴ The Law Dictionary (Black Law): <https://thelawdictionary.org/corruption/>

⁵ Angela Gorta “Reasearch: A tool for building Corruption Resistance”, Corruption and Anti-corruption, 2013, p.13.

performancës ose respektimin e detyrave publike nga dikush që konsiderohet të jetë aktorë në sferën publike.⁶

Korrupsioni përdoret nga shumë gazetarë dhe aktorë politikë si një nocion gjenerues që përfshinë të gjitha format e keqpërdorimit të funksionit, qofshin ato publike apo private. Ky term merr një kuptim më të gjerë kur përdoret për të përcaktuar qëndrime në kufijtë e ligjëshmërisë të kryera nga mbajtësitë e një autoriteti politik, administrativ (siç janë: shpërndarje e privilegjuar informacioni për krijim postesh, për projekte rregullimi të mjediseve, etj.), apo në gjirin e një ndërmarrje (montazhe kontabiliteti, evazione fiskale). Por ai korrupsion që përmban vetëm aktorë privatë, në mënyrë të veçantë ai që kryhet në marrëdhëniet midis ndërmarrjeve ka një rëndësi shumë më të vogël se ai që përmban aktorë publik.⁷

Përkufizimet akademike rreth korrupsionit kanë tendencë të specifikojnë më hollësisht situatat në të cilat sjellja mund të konsiderohet e korruptuar. Një nga përkufizimet më të hershme akademike vjen nga Robert Brooks (1910/1970, f.59), i cili e përcaktoi korrupsionin si : “keqformimi i qëllimshëm ose neglizhencën e një detyre të njohur, ose akcizën e pajustificuar të pushtetit, me motivin e fitimit të disa përparësive pak a shumë personale,,⁸

Më tej kemi edhe Nye (1967, f.419) i cili e përkufizoi korrupsionin si: “Sjellja që devijon nga detyrat zyrtare të një roli publik për shkak të përkatësisë private (personale, rrethi ngushtë familjarë) fitimet financiare ose statusore; ose shkel rregulla kundër ushtrimit të llojeve të caktuara në lidhje me ndikimin privat,,⁹

Korrupsioni me një fjalë përfaqëson një kërcënim real serioz për shtetin e të drejtës, demokracinë, për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale. Ai frenon zhvillimin ekonomik të një vendi. Për të luftuar korrupsionin në rradhë të parë kërkohet vullnet dhe përkushtim politik për të filluar dhe çuar deri në fund reformat përkatëse. Korrupsioni mund të frenohet dhe mbahet nën kontroll brenda parametrave që nuk rrezikojnë shtetin dhe shoqërinë përkatëse, por jo të zhduket.¹⁰

⁶ Robert Hughes “Corruption”, Passage of Change: Laë, Society and Governance in the Public, Canberra, 2010, pp.37.

⁷ Pierre Lascoumes “Korrupsion” Francë, 2002, fq. 30-31.

⁸ Jonathan Rose “The Meaning of Corruption: Testing the Coherence and Adequacy of Corruption Definitions”, Public Integrity, 2018, vol.20/3, f.220-233. (ebsohost.com)

⁹ Po aty.

¹⁰ Prof. Dr. Luan Gjonça “Korrupsioni, veprat penale përbërëse, krimi i organizuar”, Tiranë, 2004, fq. 301.

2. Korrupsioni dhe evoluimi historik i tij

Korrupsioni është një fenomen i vjetër që njihet që nga kohët më të lashta të shoqërisë dhe ka përfshirë të gjithë planetin. Në kohët e fundit korrupsioni është bërë një ndër termet më të përfolura dhe vlerësohet si një ndër problemet më të rëndësishme dhe aktuale pothuajse në të gjitha vendet duke mos përjashtuar edhe vendin tonë. Korrupsioni është një fenomen i ndërlikuar që shfaqet në të gjitha sferat e jetës shoqëro-shtetërore, ai kërcënon normat ligjore, demokracinë, të drejtat dhe liritë e njeriut, deformon konkurrencën e ndershme, frenon zhvillimin ekonomik, e kështu me rradhë.¹¹

Në vitin 3200 para erës sonë, Hamurabi i Babilonisë ishte bërë i njohur për shkak se e kishte urdhëruar guvernatorin e provincës që të shqyrtojë akuzat për korrupsion dhe pas rezultateve të hetimeve ka dënuar me vdekje disa zyrtarë të korruptuar. Para 3000 vjetësh, mbreti Manu i Indisë ka vendosur rregulla për konfiskimin e pasurisë së fituar me korrupsion. Në papiruset e Egjiptit të cilat i takojnë kohës para erës sonë, tregojnë për korrupsionin e ndërtuesve dhe të afërmeve të faraonëve. Në Greqinë e vjetër, korrupsioni ka qenë një prej çështjeve qendrore të shtetit, sdomos në shekujt V dhe VI para erës sonë. Në Romën e vjetër, në shekullin e I para erës sonë, korrupsioni kishte diskredituar tërë sistemin juridik. Është i njohur rasti i përfundimit të akuzës së Ciceronit kundër guvernatorit të Sicilisë, Gaius Vevreze, i cili e kontrollonte dhe e eksplatoonte Scilinë me shantazh, plaçkitje, korrupsion, vrasje, shitje të pronave publike, etj.¹²

Korrupsioni si dukuri ka lindur që në kohën kur është formuar edhe vetë shteti dhe që atëherë ka filluar shfrytëzimi dhe keqpërdorimi i shtetit për interesa materiale nga ana e administratorëve dhe zyrtarëve tjerë që e përbënin shtetin.¹³

¹¹ Po aty.

¹² Dr.sc Vetton G. Vula "Kriminaliteti i organizuar" Prishtinë, 2013, fq. 206-207.

¹³ Prof. Dr. Luan Gjonça "Korrupsioni, veprat penale përbërëse, krimi i organizuar", Tiranë, 2004, fq. 15-17.

3. Karakteristikat e korrupsionit

Fenomeni i korrupsionit nuk fillon e mbaron sot, karakteristik dhe tendencë e tij është riciklimi në vite kur i krijohen kushtet që favorizojnë një gjë të tillë.¹⁴

Karakteristikat e korrupsionit janë fshehtësia dhe diskrecioni në format e manifestimit të tij, ku fshehtësia është një mekanizëm që shërben për realizimin e objektivave të kriminalitetit të organizuar, prandaj dhe këto krime janë shumë vështirë që të zbulohen, të hetohen dhe të dënohen. Si karakteristik tjetër e korrupsionit është përshtatja, pasi që është një dukuri që përshtatet në shoqëri pavarësisht prej rregullimit shoqëror. Rrezikshmëria për shoqërinë manifestohet kur ka munges të mjeteve financiare në buxhetin e shtetit. Prandaj dhe interesi është motivi themelor i këtyre veprave penale. Me korrupsionin lidhen edhe shumë forma tjera manifestimi, perfiditeti i kryesve, vështirësitë e dëshmimit të këtyre veprave penale, etj.¹⁵

Mund të dallohen katër elemente që e karakterizojnë korrupsionin:¹⁶

1. I gjithë veprimi korruptiv konsiston në shkeljen e një norme
2. Kryhet për të marrë një përfitim privat
3. Ai lind brenda përfitimit të një funksioni të caktuar
4. Individ i korruptuar gjithmonë mundohet të mbulojë në mënyrë aktive sjelljen e tij

Këto karakteristika e bëjnë korrupsionin si diçka të paligjësme, jashtë normave dhe ligjeve të krijuar për të bashkëjetuar dhe detyrave të funksionarëve, në këtë rast funksionarëve publik. Korrupsioni prodhon përfitime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për ata që janë bashkëpunëtorë të këtij krimi. Në të gjitha këto raste, një nga elementet që e rritë edhe më shumë shqetësimin është zbulimi se korrupsioni çdo ditë e më shumë përhapet dhe se në shumë raste është socialisht e njohur dhe e pranuar, sikur të e kishim injektuar në gjakë.

¹⁴ Prof. Dr. Luan Gjonça "Korrupsioni, veprat penale përbërëse, krimi i organizuar", Tiranë, 2004, fq.300.

¹⁵ Dr.sc Veton G.Vula "Kriminaliteti i organizuar", Prishtinë, 2013, fq. 233.

¹⁶ "La Corrupcion – Características y consecuencias en Republica Dominicana", Programa de Transparencia de la Gestion Publica, Marzo, 2003, p.5.

4. Aspekte komparative të korrupsionit

Transparency International është një organizatë ndërkombëtare jo-qeveritare e cila angazhohet për luftimin e korrupsionit. Ajo është themeluar në vitin 1993 me seli në Berlin. Kjo organizatë bënë matjen e korrupsionit për të gjitha vendet e botës e cila përdorë një metodologji me mënyra të ndryshme për të patur një vlerësim sa më të saktë të nivelit të korrupsionit.¹⁷

Në vazhdim do të krahasojmë legjislacionin shqiptar dhe atë kosovar si dhe do të tregojmë se si është niveli i korrupsionit në këto vende.

4.1 Krahasim me R. Kosovës

Veprat penale kundër detyrës zyrtare paraqesin sjellje të kundërligjshme të drejtuara kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike, të cilat i kryejnë personat e autorizuar apo personat zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare apo lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare.¹⁸ Nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë të identifikuar disa vepra penale të korrupsionit por ne do t'i veçojmë disa nga ato të cilat i hasim më shpesh, si:

- **Keqëpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar** – për këtë vepër penale neni 414 i Kodit Penal tregon që personi zyrtar i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

- **Keqëpërdorimi i informatës zyrtare** – neni 416 ku tregohet se personi i cili e keqëpërdor informata të zyrtare me qëllim që për vete ose për personin tjetër të përfitojë ndonjë përparësi që nuk i takon, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

- **Konflikti i interes** – neni 417, personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare për të cilën e ka ditur apo është dashur ta dijë se ai apo ajo, ndonjë anëtar i familjes së tij ose të saj, ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të, ka interes financiar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

¹⁷ <https://www.transparency.org/>

¹⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës - neni 414,416,417,421,422.

- **Marrja e mitos** – këtu kemi nenin 421 i cili thotë që: personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

- **Dhënia e mitos** – neni 422 ku tregohet se: kushdo që në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë, për vete apo për një person tjetër i premtton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë të paarsyeshme apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

Sipas raportit Internacional të transparencës për korrupsionin e Kosovës na tregon që në pesë vitet e fundit nga viti 2016 deri në vitin 2019 ai ka pasur luhajtje, ku viti 2017 shihet që ka pasur një përmisim të madhë të situatës me 39 pikë ndërsa në vitin 2019 ka shënuar rënie në 36 pikë që i bjenë se ka pasur një rritje të korrupsionit në vend, prandaj dhe rënditja ka ndryshuar nga vendi 95 në 101. Kjo e gjitha na bënë të kuptojmë që pothuajse Kosova nuk ka pasur asnjë përparim për sa i përket luftimit të korrupsionit pasi nuk ka një përmisim të dukshëm të situatës.

Kosova në vitin 2019 nga gjithsej 180 vende ajo rënditet në vendin e 101, bashkë me Bosnjën dhe Hercegovinën, Panamën, Tajlandën dhe Perun. Me disa nga vendet e rajonit Kosova rezulton të jetë më mirë, më mirë se Maqedonia dhe Shqipëria të cilat renditen në vendin e 106-të, ndërsa vendet e tjera rezultojnë të jenë më mirë se Kosova. Ndërsa nga të gjithë vendet tjera të rajonit Sllovenia është në një rënditje më të mirë e cila rradhitet në vendin e 35.

Në vijim nëpërmjet tabelës do të paraqesim një rradhitje të vendeve të rajonit sipas indeksit të perceptimit të korrupsionit, ku mund të shihet qartë që nga të gjitha vendet e rajonit Sllovenia shihet që këtë vit është më mirë me indeksin e perceptimit për korrupsionin me 60 pikë, pastaj është Kroacia e cila poashtu ka rradhitje të mirë me 47 pikë, Mali i Zi është me 45 pikë, Serbia me 39 pikë, Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë pikë të njëjta me 36 pikë që nuk paraqet një situatë fortë të mirë, mirëpo më keq nga të gjitha vendet siç mund të shihet edhe nga tabela janë Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut me 35 pikë.

Tabela 1. Radhitja e vendeve të rajonit sipas transparencës përmes indeksit të perceptimit të korrupsionit

Renditja	Vendi	Pikët
35	Slovenia	60
63	Kroacia	47
66	Mali i Zi	45
91	Serbia	39
101	Kosova	36
101	Bosnja dhe Hercegovina	36
106	Maqedonia e Veriut	35
106	Shqipëria	35

Burimi: Autori

Për korrupsion më të ulët paraqiten dhe renditen në vendet e para vendet e Evropës, përkatsisht vendet skandinave me Zelandën e Re, të cilat qëndrojnë për disa vite rresht në vendet e para të ranglistës. Për vitin 2019 numër 1 apo në vendin e parë në listë gjendet Zelanda e Re me Danimarkën me nga 87 pikë, kurse vendin e fundit e ndajnë Korea e Veriut me 12 pikë dhe Somalia me 9 pikë. Të njëjtat mund t'i shohim më mirë të paraqitura në Shtojcën 1.

4.2 Krahësim me R. Shqipërisë

Si vepra penale të korrupsionit në Kodin Penal të Shqipërisë janë disa vepra nga ku edhe këtu do të veçojmë disa:¹⁹

- **Keqëpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar** – neni 164, tregon që shpërdorimi i kompetencave nga anëtarët e këshillit apo administratorët e shoqërisë me qëllim përfitimi apo për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjetë.
- **Dhënia e mitos** – neni 259, kryerja e veprimeve nga punonjësi i ngarkuar me funksion shtetëror apo në shërbim publik, për të kërkuar ose urdhëruar dhënien e shpërblimeve që nuk i takojnë ose më shumë nga sa i takojnë sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë (7) vjet.

¹⁹ Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë – neni 164,259,260.

- **Marrja e mitos** – neni 260, marrja e shpërblimeve, dhuratave ose përfitimeve të tjera prej punonjësit të ngarkuar me një funksion shtetëror apo në shërbim publik e në ushtrim të tyre, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me funksionin apo shërbimin ose për të përdorur ndikimin pranë autoriteteve të ndryshme për të siguruar çdo personi favorizime, dallime, vende pune e përfitime të tjera, dënohet me burgim nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

Raporti i organizatës “Transparency International,, tregoi që Shqipëria prej vitit 2013 deri në vitin 2017 ka pasur një përmissim të madhë duke lëvizur nga 31 në 38 pikë, mirëpo në vitin 2018 dhe 2019 ka pasur përkeqësim të situatës në krahasim me vitin paraprak pasi ka pësuar një rënie, ku në vitin 2019 Shqipëria është rënditur në vendin 106 në krahasim me vitin paraprak që është rënditur në vendin e 99, pra shkalla e korrupsionit ka lëvizur nga 36 në 35 pikë.

Shkak për përkeqësimin e situatës së Shqipërisë në raport thuhet se mund të jetë një ngërç politik që bllokoi disa reforma të anti-korrupsionit që të ecin përpara.²⁰

Shqipëria bashkë me Maqedoninë, Brazilin, Mongolin, Algjerin, Brigjet e Fildishtë dhe Egjiptin renditen në vendin e 106-të. Ndërsa me vendet e rajonit duket që Shqipëria dhe Maqedonia kanë një rënditje të njejtë dhe rezultojnë të jenë më keq se vendet e tjera.

Në vijim nëpërmjet tabelës do të paraqesim radhitjen e Shqipërisë dhe Kosovës prej vitit 2010 e deri në vitin 2019, ku mund të shihet shumë qartë se si ka lëvizur niveli i korrupsionit për këto vite, nëse ka pasur përmissim apo përkeqësim të situatës.

²⁰ Balkan Web <https://www.balkanweb.com/shifrat-shqiperia-zhytet-ne-korrupsion-zbret-me-8-vende/>

Tabela 2. Radhitja dhe indeksi i korrupsionit për Shqipërinë dhe Kosovën për periudhën 2010-2019

	Shqipëria		Kosova	
Viti	Renditja	Pikët	Renditja	Pikët
2010	87	33	110	28
2011	95	31	112	29
2012	113	33	105	34
2013	116	31	111	33
2014	110	33	110	33
2015	88	36	103	33
2016	83	39	95	36
2017	91	38	85	39
2018	99	36	93	37
2019	106	35	101	36

Burimi: Autori

Nga tabela ²¹ shihet që Shqipëria për dhjetë vitet nivel më të lartë të korrupsionit ka pasur në vitin 2013 e renditur në vendin 116 me 31 pikë, ndërsa më pakë ka qenë në vitin 2016 e renditur në vendin e 83 me 39 pikë. Kosova shihet që në vitin 2011 ka pasur nivel më të lartë të korrupsionit në krahasim me vitet tjera dhe është renditur në vendin e 112 me 29 pikë, ndërsa korrupsion më të ulët ka pasur në vitin 2017 e renditur në vendin e 85 me 39 pikë. Ndërsa nëse i krahasojmë këto vende ndërmjet veti atëherë shohim qartë që rënditje dhe indeks më të mirë të korrupsionit ka pasur Shqipëria e cila edhe pse ka pasur herë rritje e herë ulje mund të thuhet që mesatarisht për 10 vite ajo rrënditet në vendin e 99 në krahasim me Kosovën e cila mesatarisht rrënditet në vendin e 102.

²¹ Të dhënat janë marrë nga <https://www.tradingeconomics.com/>

Kreu II

1. Aspekte Juridiko-penale të korrupsionit

Nocioni i korrupsionit nga aspekti juridiko-penal është relativisht i ngushtë dhe përfshinë inkriminimet për mitë pasiv dhe aktiv, ndërmjetësim kundërligjor dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare për të pasur të mira për vete apo për tjetrin. Këto vepra penale kryhen nga: personat zyrtar, personat përgjegjës dhe personat që kryejnë punë për interes publik.²²

Ndër grupet më të dalluara të veprave penale dhe shkeljeve korruptive antiligjore janë:²³

1. Veprat penale korruptive – të cilat vepra ndahen në:

- Vepra penale korruptive publike – ku përfshihen të gjitha veprat penale të karakterit publik dhe janë parashikuar në legjislacionet penale përkatëse të shteteve të botës.
- Vepra penale korruptive jopublike – këto vepra kanë të bëjnë me shpërdorimin e plotfuqishmërisë në tërësi në çdo fushë të jetës.

2. Veprimet korruptive të së drejtës civile – këtu mund të përmendim ato shfaqje të korrupsionit, që lindin në marrëdhëniet e krijuara për shkak të përgjegjësisë, funksionit apo vendit të punës dhe janë të lidhura me shfrytëzimin e tyre për të krijuar përfitime moralo-materiale. Si të tilla mund të përmendim:

- Pranimi i dhuratave apo bakshisheve prej qytetarëve nga ana e punonjësve të institucioneve shtetërore, apo komunale.
- Marrja e dhuratave apo përfitimeve tjera nga ana e punonjësve të institucioneve shtetërore ose të organeve të shërbimit qendror apo lokal
- Shpërblim për shërbimet që ata janë të detyruar t'i kryejnë në shërbim të komunitetit, falë detyrave të tyre funksionale për të cilat paguhet me rrogë nga taksapaguesit e këtij komuniteti.

3. Veprimet korruptive administrative – paraqesin të gjithë veprimet ose mosveprimet e karakterit administrativ, apo shkeljeve të parashikuara në rregulloren e administratës

²² Grup Autorësh “Kriminaliteti i organizuar – Aspekte Juridike” Tetovë, 2009, fq. 192.

²³ Luan Gjonça “Korrupsioni – veprat penale përbërëse, krimi i organizuar”, Tiranë, 2004, fq. 75-83

publike që një ofiqar i kryen, me qëllim për të realizuar përfitime apo privilegje të paligjshme.

4. **Veprimet korruptive disiplinore** – paraqesin shfrytëzimin e shërbimeve publike, organizatave joqeveritare, shoqatave tregtare, nga ana e ofiqarve shtetëror për të përfituar privilegje në kundërshtim me ligjet apo rregulloret përkatëse , për të cilat parashikohen edhe ndëshkime disiplinore.

Nga Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të identifikuara disa vepra penale të korrupsionit si:²⁴

– **Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar** – për këtë vepër penale neni 353 i Kodit Penal tregon që kjo vepër penale kryhet nga persona zyrtarë të cilët e shfrytëzojnë pozicionin e tyre zyrtar duke tejkaluar kufijtë e tyre si persona zyrtar ose duke mos kryer detyrat e tyre zyrtare me qëllim që të përfitojë çafreëdo dobie për veten ose për personin tjetër apo do t'i shkaktojë dëm tjetërit ose t'i shkel të drejtat e tjetrit. Këto persona do të ndëshkohen me burgim nga 6 muaj në 3 vjetë.

– **Marrja e mitos** – kryerës i kësaj vepre penale sipas nenit 357 të Kodit Penal mund të jetë personi përgjegjës dhe zyrtar. Këto persona pranojnë ose kërkojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë dhurata ose përfitime të tjera për vete ose për person tjetër ashtu që të kryej brenda autoritetit të tij zyrtar një akt zyrtar ose të mos lejoj kryerjen e ndonjë vepre zyrtare që duhet të kryhet. Këto persona dënohen me burgim nga 4 deri në 10 vjetë.

– **Dhënia e mitos** – për këtë vepër penal sipas nenit 358 të Kodit Penal kryerës mund të jetë çdo person i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë i jep ose i premton një dhuratë ose përfitim tjetër me qëllim që t'i kryej brenda autoritetit të tij zyrtar disa punë zyrtare që nuk duhet të kryhen ose mos kryerja e ndonjë akti zyrtar që duhet të kryhet. Këto persona të kryerjes së kësaj vepre penale do të dënohen nga 1 deri në 5 vjetë burgim.

– **Ndërmjetsimi kundërligjor** – nga neni 359 i Kodit Penal kryerës i kësaj vepre penale është ai person zyrtar që pranon shpërblim apo përfitim tjetër duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare shoqërore dhe ka ndikim që të ndërmjetësojë apo që të mos kryhet ndonjë veprim zyrtar. Këto persona do të gjobiten pra me denim me para ose do të kenë denim me burg deri në 3 vjetë.

²⁴ Kodi Penal i RMV, <https://www.akademika.com.mk/>, Kodi Penal, neni 353, 357, 358, 359.

2. Aspekte sociologjike të korrupsionit

Korrupsioni në një shoqëri mbizotëron nga kultura dhe struktura shoqërore. Korrupsioni në formën e miteve dhe pushtetit është i pranishëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë në të gjitha departamentet dhe në të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Perspektiva sociologjike përfshin fushat e zhvillimit të jetës shoqërore, marrëdhëniet shoqërore të individëve, grupeve dhe institucioneve. Ekzistojnë shumë teori në lidhje me sociologjinë e shoqërisë, nga të cilat do veçojmë teorinë nga Karl Marx (1818-1883) dhe teoria tjetër që është ajo e C. Wirght Mills (1916-1961).²⁵

Teoria e Karl Marx - nëpërmjet kësaj teorie ai shpjegon që vlerat kulturore njerëzore janë të rëndësishme për një shoqëri dhe se fuqia dhe paraja formojnë strukturën shoqërore përmes zhvillimit të luftës midis klasave për të arritur sa më mirë. Sipas besimit të tij, kërkesa për të arritur pasuri dhe fuqi nuk shfaqë vetëm negativitet në shoqëri, por ajo mund të shihet edhe nga aspekti pozitiv që del në pah vetëm nëse diferencës së klasës së sipërme dhe të poshtme i është dhënë një fund dhe nëse ka barazi dhe gjithëpërfshirje në shoqëri. Sipas tij materializimi dhe fuqia kanë rëndësi të madhe dhe mund të bëjnë ndryshimet në shoqëri. Ai tregoi vështrim materialist për historinë që njerëzit fitojnë për ushqim, strehim, shtëpi, veshje dhe punojnë për jetesën e tyre. Kjo betejë formon strukturën shoqërore të shoqërisë duke krijuar punët dhe pronarët. Këto dy ndarje të njerëzve krijojnë ndryshime pasi pronarët fitojnë fitim, por paguajn më pak sesa vlera e punës, gjë që çon në shfrytëzimin e shoqërisë. Ky shfrytëzim sjell më tej studimin politik duke krijuar klasa në fuqi që janë ekonomikisht të fortë dhe kështu fitojnë fuqinë e kontrollit të vendit.

Teoria e C. Wright Mills – ai konsiderohet themeluesi i teorisë së konfliktit dhe sipas tij njerëzit që kanë shumë fuqi, janë në gjendje të marrin vendime me pasoja të mëdha. Kështu sipas kësaj teorie, struktura shoqërore është e formuar nga negociatat dhe lufta e njerëzve që i përkasin zonave të ndryshme, të të menduarit, të ideve dhe të interes, pra njerëzit me fuqi dhe me burimet e tyre e formojnë shoqërinë. Ai shpjegon se problemet dhe çështjet personale gjithashtu kanë ndikim në strukturën e shoqërisë dhe fuqia ekonomike nuk është e vetmja gjë, që sjell konflikt në shoqëri. Sipas tij, një shoqëri e mire mund të ekzistojë duke e zhdukur ndryshimin midis njerëzve me pushtet të plotë dhe atyre të pafuqishëm dhe duke sjellë barazi mes njerëzve.

²⁵ Sociological Theories and Corruption Sociology Essay, UK, 2018.

<https://www.ukessays.com/essays/sociology/sociological-theories-and-corruption-sociology-essay.php>

Sipas këtyre dy teorive erdhëm në përfundim se kushtet ekonomike dhe ato politike nuk janë të vetmit faktorë që prekin shoqërinë, por që ekzistenca e klasave shoqërore dhe shpërndarja e fuqisë në mesin e njerëzve të klasave sociale krijon dhe ndihmon korrupsionin të rritet në një vend.

3. Ndryshimet sociale dhe korrupsioni

Nga definimet e mëparëshme në lidhje me korrupsionin kuptuam që ai egzistonë kudo dhe se ky fenomen dallon nga vendi në vend varësisht nga mënyra dhe sasia. Dhe sipas kësaj gjithçka varet nga ndjeshmëria sociale. Për sa i përket kësaj për vendet e pazhvilluara thuhet që: sa më i varfër dhe i prapambetur të jetë një vend, aq më i lartë do të ishte niveli i korrupsionit dhe format e tij do të ishin më transparente.

Korrupsioni, si produkt socialo – moral në një shoqëri gjatë veprimtarisë së tij gërsheton marrëdhëniet sociale me ato shtetërore që krijohen apo ekzistojnë, gjë që e kthejnë korrupsionin në faktor të sistemit shoqëror. Efektet ekonomike dhe sociale të korrupsionit janë tejet serioze për çdo shoqëri. Korrupsioni prodhon varfëri dhe rënie të përgjithshme ekonomike, shoqëruar me pakënaqësi shoqërore ndaj reformave për zhvillimet demokratike dhe minimizimin e besimit të qytetarëve te organet e shërbimit public shtetëror.²⁶

Politikat sociale kanë ndikim të madhë dhe të drejtepërdrejt në të drejtat e qytetarit të një vendi, të cilat të drejta janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura me të drejtat ekonomike dhe sociale. Vendi jonë është një ndër vendet që synon të integrohet në Bashkimin Evropian prandaj dhe këto politika kanë një rolë shumë të madhë. Për ndryshimin e politikave sociale merret Qendra për Hulumtime në të drejtat e njeriut dhe integritet Evropiane me qëllim që të analizojnë dhe të përshtatin situatën aktuale sociale të vendit.²⁷

Korrupsioni ndikon në mirëqenien e antërëve të shoqërisë së një vendi, prandaj dhe perceptimi i qytetarëve për të përbën një çështje të rëndësishme pasi lidhet ngushtë me gjendjen ekonomike të tyre. Korrupsioni ul standartin e jetesës së pjesës më të madhe të popullsisë së një vendi ngaqë, numri i personave që përfitojnë nga korrupsioni është më i vogël se pjesa tjetër e popullatës. Ulja e të ardhurave çon në reduktimin e standartit të jetesës së qytetarëve. Prandaj korrupsioni ndikon negativisht në pabarazinë shoqërore.

²⁶ Luan Gjonça “Korrupsioni – veprat penale përbërëse, krimi i organizuar”, Tiranë, 2004, fq.301.

²⁷ Valon Murati & Qerkin Berisha “Politikat sociale në Kosovë: skemat sociale dhe përshtatshmëria e tyre me realitetin kosovar”, Prishtinë, 2010, fq.5.

aktet e vazhdueshme të korrupsionit krijojnë një kulturë institucionale të korrupsionit dhe ulin besimin e popullatës tek institucionet publike.²⁸

Korrupsioni është një vepër penale por edhe njëkohësisht ndikon në rritjen e veprave tjera penale, siç janë: vjedhja, vrasja, etj. Pasi që kur rritet shkalla e korrupsionit ajo e ulë nivelin e të ardhurave për pjesën më të madhe të popullsisë dhe kjo do të sjellë rritje të mundësive për kryerjen e vjedhjeve duke e parë si një mundësi për të siguruar të ardhura për jetesën.²⁹

4. Shkaqet e paraqitjes së korrupsionit

Shkaqet e paraqitjes së korrupsionit janë të shumta dhe të llojllojshme të cilat mund të varojnë nga elementet gjyqësore deri te ato politike, nga elementet administrative deri te ato sociale dhe ekonomike. Ndër shkaqet kryesore janë:³⁰

a) Mungesa e informacionit – këtu bëjnë pjesë:

– *Sjellja e personelit* - mungesë e interesit për zgjedhjen e ndonjë çështje, shtyrje të pajustificuara, mungesë e njohjes së qarkut të brendshëm të dokumenteve ose ku të gjendet informacioni, qytetarët do t'i marrin këto sikur duan të thonë se interesi i personelit në çështjet përkatëse duhet të stimulohet ose që këto elemente nënkuptojnë një kërkesë për mitë.

– *Mungesa e informacionit për mënyrën se si funksionon sistemi* – qytetarët shpesh nuk janë në dijeni për të drejtat e tyre dhe nuk kanë një informacion të nevojshëm se si funksionon sistemi gjyqësor për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe kjo krijon një shoqëri të cënueshme nga mashtrimi i individëve që kërkojnë mitë në shkëmbim të kryerjes ose përshpejtimit të një zgjedhjeje për çështjet përkatëse.

– *Qasje e papërshtatshme për qytetarët ndaj legjislacionit* – udhëzimet e postuara nëpër faqe të internetit të institucioneve të ndryshme ose të disa gjykatave në shumicën e rasteve janë më tepër ekstrakte nga tekstet e ligjeve se sa fletëpalosje që u shpjegojnë qytetarëve të zakonshëm se cilat janë të drejtat e tyre dhe mjetet procedurale me anë të të cilave të mbrojnë të drejtat e tyre.

²⁸ Sali Shehu "Korrupsioni - këndvështrim shoqëror, kriminologjik dhe penal" Tiranë, 2017, fq. 43-44.

²⁹ Mirela Kapo " Veprat penale në administratën publike, aspektet doktrinale dhe praktike në legjislacionin Shqiptar", Tiranë, 2017, fq. 74.

³⁰ Cristi Danilet "Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë", Tiranë, 2011, fq.48-55.

– *Qasja e dobët në jurisprudencë* – egzistojnë programe kompjuterike të cilat përmbajnë jurisprudencën dhe janë pa pagesë, por këto programe më së shumti përdoren brenda gjykatave dhe prokurorive të caktuara, ndërsa publiku nuk ka qasje ndaj bazës së të dhënave as edhe për çështjet në të cilat ata janë të përfshirë. Edhe pse në Janar të vitit 2006 u është kërkuar të gjitha gjykatave që të bëjnë jurisprudencën e tyre nëpërmjet internetit por ende nuk kanë arritur të botojnë të dhënat e kërkuara.

– *Bashkpunimi jo i duhur me masmedian* – informacioni konfidencial shpesh rrjedh gjatë proceseve gjyqësore, në shumicën e rasteve për shkak të 'mirëkuptimit' midis gazetarëve dhe punojnësve të caktuar. Për shembullë, në qoftë se shefi i një institucioni gjyqësorë bashkëpunon me median rregullisht, ky zyrtar mund të përfitojë që media të mos e botojë kritikën publike që ka si objekt zyrtarin ose aktivitetet e institucionit, ose zyrtari mund të jetë në gjendje që ta përdor median si një mjet për të shkarkuar hakmarrjen ose presionin personal.

b) Mungesa e kontrollit dhe përgjegjshmërisë³¹

– *Mungesa e demokracisë gjyqësore* – fatëkeqësisht rregullat e pashkruara akoma mbështesin sistemin gjyqësor dhe janë përjetësuar për shkak të mungesës së kulturës së etikës profesionale. Këto rregulla përfshijnë por nuk kufizohen me atë që shefat nuk kritikohen, fshihet inkompetenca, të mos zbulohet korrupsioni, të fitohet mbi median, sindikata e institucionit të dobësohet ose diskreditohet ose që udhëheqësve të tyre tu mohohet pushteti i përfaqësimit.

– *Mospërfshirja e shoqërisë civile në monitorimin e sistemit* – gjykatat dhe prokuroritë janë të mbyllura ndaj bashkëpunimit me organizatat joqeveritare që identifikojnë gabimet specifike organizative; aty ku egzistojnë raporte të vlerësimit të jashtëm, ato anashkalohen dhe rekomandimet e tyre nuk implementohen.

– *Kompetenca profesionale e dobët* – si pavarësia dhe integriteti janë të bazuar në trajtimin tërësor profesional. Aty ku mungojnë këto cilësi ose janë të pamjaftueshme dhe kur personelit u krijohen raste për përfitime shtesë, shanset për korrupsion rriten.

– *Burokracia e tepërt dhe mungesa e organizimit* – qarku i koklavitur i dosjeve dhe të dhënat parësore, procedurat e stërzgjatura dhe jofleksibile për marrëdhëniet me publikun, nëpunësit e pasjellshën që i kalojnë qytetarët nga një zyrë në një tjetër, mund t'i bëjnë

³¹ Cristi Danileț "Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë", Tiranë, 2011, fq.48-55

njerëzit të ndjenjë se ata nuk kanë opion tjetër veçse t'iu drejtohen lidhjeve Brenda sistemit dhe të kryejnë aktet e korrupsionit.

– *Frika nga hakmarrja* – çdo punojnës që ka dijeni për veprimet e paligjëshme ose joetike të kryera nga kolegët e tij pse të saj, eprorët ose varësit është nën detyrim ligjorë dhe moral t'ua raportojë institucioneve përkatëse. Për shkak të rsikut të ekspozimit, nuk raportohen faktikisht shkeljet, megjithëse mos njoftimi i organeve gjyqësore për zbulimin e një shkeljeje në vendin e punës, në vetvete është një krim. Kodet e etikës profesionale të policisë dhe personelit të vendeve të vuajtjes së dënimit janë të vetmet që specifikisht e ndalojnë tolerancën për shkeljet e korrupsionit dhe i detyrojnë punojnësit të informojnë eprorët dhe organet kompetente për shkeljet për të cilat ata janë në dijeni. Për personat që raportojnë veprat e paligjëshme dhe joetike egzistojnë dy ligje që sigurojnë mbrojtjen kundër hakmarrjes që janë: ligji për mbrojtjen e dëshmitarit dhe ligji për mbrojtjen e integritetit të denoncuesve.

– *Mekanizma të gabuar të përgjegjshmërisë* – korrupsioni lulëzon aty ku risku i ekspozimit dhe ndëshkimeve është i ulët. Aktualisht me heqjen e mjeteve për rishikimin e vendimeve (masë apelimi special e përdorur kundër gjykimeve të formës së prerë), gjyqtarët e Gjykatës së Apelit mund të vendosin sit ë duan, sepse nuk ka mjete për kundërshtim (që gjykimet janë të formës së prerë). Rreziku i vendimeve arbitrare për këtë asye është i lartë. Megjithëse janë raportuar gabime të rënda të gjykimit gjatë viteve, nuk ka pasur penalitete të çfarëdo lloji për ata që i kanë bërë ato. Pavarësisht nga dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë civile edhe penale, pandëshkueshmëria në lidhje me gabimet e kryera me qëllim ose nga neglizhenca e rëndë shkaktojnë kosto të rëndësishme për përdoruesit e gjykatës dhe shoqërinë dhe forcojnë ndjenjën se gjyqtarët dhe prokurorët janë mbi ligjin. Gjithashtu toleranca për këto çështje (vetëm pak deri tani), krijon një emër të keq për shumicën e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe nëpunësit civil edhe për ata që janë të ndershëm. Veç kësaj, është edhe risku i vogël që nëpunësit civil të pandershëm të penalizohen. Mungesa e integritetit thellohet më tej nga mosarritja shkurajuese e penalizimit të të korruptuarve.

– *Rregullime që lejojnë vendimet me diskrecion* – korrupsioni mund të ndikojë në vendimet që merr policia dhe prokurorët për të filluar një ndjekje penale, në transferimin e çështjeve nga një organ hetimor tek një prokuror, transferimin e çështjeve nga një prokuror tek një agjenci e një niveli më të lartë të ndjekjes penale, për të përcaktuar nëse kriteret e

aplikuara në një ndëshkim do të jetë ndëshkim administrativ në vend të atij penal, apo për të vendosur se cila do të jetë shkalla e dënimeve që do të marrin gjykatësit. Kjo mund të ndodhë sepse vendimet e lartëpërmendura bazohen në kriteret e përgjithëshme të parashikuara nga ligj, me diskrecionin e gjerë të organit gjyqësorë që luan një rol kyç. Ky diskrecion shpjegon përse gjyqëtarët mund të marrin vendim ndryshe në çështje të ngjashme. Për shembull, kjo mund të shpjegojë për sa vepra penale të ngjashme të kryera në rrethana të ngjashme, kanë diferenca të mëdha midis rezultateve në gjykata të ndryshme, disa të dyshuar arrestohen dhe të tjerë nuk arrestohen, ose për se disa të burgosur dënohen dhe për disa të tjerë nuk dënohen.

c) Oportunitetet³²

– *Pagat e ulëta* – të ardhurat mujore të gjyqtarëve janë të arsyeshme por pagat e personelit ndihmës, veçanërisht ato të nëpunësve të arkivit dhe të agjentëve procedural janë shumë të ulëta, gjë që mund të injkurajojë korrupsionin administrativ. Një rritje në të ardhura nuk është e vetmja masë mbrojtëse kundër korrupsionit (në faktë, midis vitit 2005 dhe 2008, pagat e gjyqëtarëve dhe prokurorëve u dyfishuan, megjithatë u rrit numri i çështjeve të korrupsionit që përfshinin gjyqatrët dhe prokurorët gjithashtu). Kjo duhet të shoqërohet me një ndryshim në qëndrime, me krijimin e një sistemi profesional të bazuar tek merita dhe me miratimin dhe zbatimin e rregullave antikorrupsion.

– *Kufizimet e imponuara nga natyra e pozicionit* – ligji i ndalon personelit gjyqësor që të punësohen në pozicione të tjera, me përjashtim të disa posteve të mësimdhënies në shkollat e larta juridike. Ky ndalim, ndikon në mënyrë të paarsyeshme, mes të tjerash, tek personeli ndihmës në gjykata dhe prokurori, të cilat nuk mund të marrin ligjërisht të ardhura shtesë, megjithëse nuk janë të përfshirë në vendimmarrje gjyqësore.

– *Kontakti i drejtëpërdrejtë me publikun* – diskrecioni, i kombinuar me kontaktine drejtëpërdrejt me publikun gjeneron dobësi. Aktiviteti për një kohë të gjatë në të njëjtin post gjithashtu krijon efekte të ngjashme; në qoftëse dikush punon për një kohë të gjatë në të njëjtin pozicion, krijohen marrëdhënie si Brenda dhe jashtë institucionit që mund të inkurajojnë fshehjen e korrupsionit dhe trajtimin preferencial. Kjo mund të ndodhë në mënyrë të veçantë mes atyre punonjësve të cilët kanë kontakt të drejtëpërdrejtë me publikun, por edhe midis atyre punonjësve në departamentet ndihmëse p.sh burimet njerëzore.

³² Cristi Danileț “Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë”, Tiranë, 2011, fq.48-55

– *Çështjet e profilit të lartë* – etja për para të shpejtë dhe të lehtë provokohet nga kontakti me çështje palët e të cilave janë përfshirë në asete tepër të vlefshme ose politikanë/afaristë që hetohen penalisht, gjithë ata që mund të jenë në gjendje të ofrojnë shuma të mëdha parash ose përfitime të tjera në shkëmbim të vendimeve të favorshme.

d) Rrethanat shoqërore³³

– *Ndjekja e të njëjtave shkolla, shoqata dhe qarqe, si dhe marrëdhëniet e ngushta fisnore* – këto marrëdhënie lehtësojnë kontaktet e drejtëpërdrejta me individët që kanë detyra gjyqësore të cilat mund të inkurajojnë mitëdhënien dhe tregtimin në influencë. Kërcënimi i lartë që paraqesin këto marrëdhënie midis gjyqëtarëve dhe prokurorëve, nëpunësve të gjykatës, punojnësve të policisë me kolegët e tyre të mëparshëm të cilët janë bërë avokatë dhe nga politikanët që gjithashtu janë avokatë, e bëri legjislaturën që të paraqes një numër kufizimesh për praktimin e ligjit.

– *Toleranca në shoqëri* – në shumë fusha njerëzit e konsiderojnë pengesën e shumave shtesë të parave në shkëmbim të shërbimeve si ‘normale’. Zakonisht pacientët e quajnë normale që të paguajnë para shtesë për doktorët e tyre; në mënyrë të ngjashme, përdoruesit e gjykatës janë më të interesuar në atë se si të fitojnë favorin e trupit gjykues më tepër se sa paraqitjen e paanshme të çështjes së tyre.

– *Moskultivimi i nderit dhe integritetit* – etika në sistemin gjyqësor reflekton etikën e shoqërisë rumune, e cila është disi e ulët. Kjo ndodh sepse nuk ka vlerësim etik kur punësohen aplikantët dhe gjatë gjithë karrierës së tyre, vlerësimet janë disi të përcipta dhe ndonjëherë janë një mjet presioni në duart \e vendimmarrësve. Ka pak ose aspak seminare që fokusohen tek etika dhe paanshmëria dhe nuk ka fare nga ata që të trajtojnë antikorruptionin. Kultura e shërbimit të interesave publike promovohet më mirë mes punojnësve të policisë më tepër se sa mes personelit të gjykatave apo prokurorive.

– *Zakoni ose instikti* – për sa kohë që një punojnës është përfshirë në shkeljet e korrupsionit dhe nuk është penalizuar, ose për sa kohë që bashkëpunorët kanë bërë të njëjtën gjë, ata do të inkurajohen të adoptojnë ose të vazhdojnë me të njëjtat forma të shkeljeve.

³³ Cristi Danileț “Korrupsioni dhe antikorruptioni në sistemin e drejtësisë”, Tiranë, 2011, fq.48-55

5. Korrupsioni si pengesë e shoqërisë

Korrupsioni në shoqëritë e sotme shihet nga dy këndvështrime, si: Korruptimi juridik – që paraqet shkelje të rendit kushtetues, për shkak se godet garancitë kushtetuese për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe për rrjedhojë cënon agresivisht marrjen e cilësinë e shërbimeve publike, duke favorizuar e privilegjuar të inkriminuarit, njerëzit e pushtetit a politikës ose ata që i blejnë shërbimet përkatëse. Dhe korruptimi ekonomik – që shfaqet me synimin e realizimit të pozitave të privileguara e monopolistike të individëve apo grupeve rreth tyre në drejtim të koncesioneve, privatizimeve, tenderave, duke asgjësuar pa mëshirë ligjësitë objektive të ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së hapur e duke i zëvendësuar ato me praktika shkatëruëse e abusive që u kundërvihen ligjëshmërive e rregullave të miratuara.³⁴

5.1 Korrupsioni si pengesë e zhvillimit të reformave në shoqëri

Për një kohë të gjatë, kryerësit e veprave penale të korrupsionit dënoheshin me dënime të ashpëra ku ekzekutoheshin si vrasës dhe si armiqë të shtetit, por më vonë këto dënime u hoqën si pasojë e asaj se prej atyre dënimeve nuk patën rezultate adekuate, kjo ndoshta ishte nga fakti se korrupsioni zhvillohej nga mbajtësit e pushtetit politik dhe organet legjislativë kishin shumë pak ndikim. Edhe sot korrupsioni është vepra penale më e përhapur dhe është vështirë për tu reduktuar, pasi që këto vepra kryhen nga persona të cilët edhe nëse marrin apo japin mite nuk duan që të zbulohen. Prandaj dhe mund të themi që është shumë vështirë të luftohet korrupsioni vetëm përmes ligjeve penale pasi konsiderohet si e pamjaftueshme, por edhe nuk mund të thuhet se është problem vetëm i shoqërisë, por që është një çështje që duhet të trajtohet ekskluzivisht nga policia, prokuroria dhe gjykatat.³⁵

Korrupsioni është një fenomen heterogjen që përfshin aspekte të ndryshme të jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të shoqërisë dhe ndodh dhe edukohet në mënyra të ndryshme.³⁶

Korrupsioni është një dukuri që ndikon në ekonominë e vendit, në ngadalësimin e rritjes ekonomike, por gjithashtu ndikon në shoqërinë, ku prek të gjithë shoqërinë pa

³⁴ Sali Shehu “Korrupsioni - këndvështrim shoqëror, kriminologjik dhe penal” Tiranë, 2017, fq. 27-28.

³⁵ Rade Bogojevic & Tatjana Skakavac “Corruption as an obstacle to European Integrations”, Serbia, 2018, fq.59-60.

³⁶ L. Grigorev & M. Ovchinnikov “Corruption as an Obstacle to Modernization”, Problem of Economic Transition, 2009, vol.51/11, f. 40-61.

përrjashtim. Ai është i përhapur në të gjitha serrat e jetës, ku më së shumti mund të shihet në arsim ku studentët për ndonjë notë të mirë apo për të mos e përsëritur vitin mundohen që nëpërmjet mitëdhënies të e kalojnë këtë situatë, gjithashtu këtë dukuri e hasim edhe nëpër spitale, ku njerëzit japin para nga frika se nuk do t'i shërbejnë si duhet, apo për një kujdes më të mirë. Kështu nga e gjitha kjo mund të thuhet se dikush jep mitëdhënie me dëshirë, e dikush tjetër ndihet i detyruar që të jap, por është me rëndësi që shteti të përmirësoj mënyrën se si e kontrollon korrupsionin ashtu që institucionet të funksionojnë për të gjithë njësojë. Korrupsioni shihet si një taks jo zyrtare për shoqërinë dhe rrit hendekun midis të pasurëve dhe të varfërve, por nga e gjithë shoqëria më së shumti që preken nga korrupsioni janë ato që janë më pak të aftë për të paguar, pra shtresat e varfëra, pasi që për shtresën tjetër, pra për të pasurit të arrijë në atë se çfarë dëshiron nuk i kushton asgjë ajo që do jep ndonjë qindrakë më shumë, por për të varfërit kjo kushton shumë.

5.2 Korrupsioni i “Jakave të bardha”, kërcënim për shtetin e së drejtës në RMV-ut

Kriminaliteti i “Jakës së bardhë” konsiderohet si formë e kriminalitetit profesional apo krim i kryer nga shtresat e larta në shoqëri. Ky lloj kriminaliteti quhet profesional ngase kryhet nga persona të cilët me sjellje kriminale merren në mënyrë të rregullt dhe kjo është bërë profesion dhe mjeshtri e tyre, kështu dhe realizojnë të ardhura dhe fitime të mëdha. Termi kriminaliteti i “Jakës së bardhë” për herë të parë është përdorur nga kriminologu dhe sociologu amerikan Edvin Sutherland në SHBA, ku sipas tij ky lloj kriminaliteti ka të bëjë me individ dhe grupe që kanë pozita dhe ndikim në të gjitha segmentet e pushtetit politik, ekonomik, financiar, gjyqësorë dhe segmente tjera të jetës.³⁷

Kriminaliteti i “Jakave të bardha” u shfaqë në mesin e shekullit XIX, para këtij shekulli kanë qenë forma të tjera të krimeve të përhapura, por sot për kto afera kriminale të këtij lloji të krimit, çdo ditë diskutohen si pjesë e jetës së përditshme. Individët që e kryejnë këtë krim nuk konsiderohen si kriminelë, por njerëz të biznesit që i përdorin pozitat e tyre pasi kanë mundësi dhe ashtu “menaxhohen” për të qendruar në treg dhe në kundërshtim me urdhërat e statutit ata gjejnë arsyetimin se ligjet janë konzervatore dhe nuk përshtaten me biznes klimën e epokës së re, specifikat dhe nevojat e tregut dhe me kushtet fitimprurëse të biznesit.³⁸

³⁷ Ragip Halili “Kriminologjia”, Prishtinë, 2011, fq. 137-139.

³⁸ Шериф Салоски “Криминалитет на Белите Јаки”, август, 2014.

Analisti Naim Kelmendi konsideron se kriminaliteti politik dhe ai ekonomik burojnë dhe zhvillohen kryesisht nga kriminelët e “Jakës së Bardhë” të cilët shumë lehtë kalojnë të paprekur pasi që kanë fuqi të madhe ndikuese dhe ushtrojnë presion të kundërligjshëm edhe ndaj prokurorive dhe gjykatave, përmes rrjetit të “sekserëve” të tyre besnikë. Ai thot se e gjitha kjo ndikon negativisht dhe po e pamundëson zhvillimin e shtetit të së drejtës, shtetit të zhvillimit ekonomik dhe të perspektivës së qartë për qytetarin.³⁹

Ky lloj kriminaliteti në fillim është përhapur në SHBA, mirëpo sot mund të thuhet që ai është prezent nëpër të gjitha vendet e botës dhe paraqet një rrezik të madhë për shoqërinë bashkëkohore. Personat që kryejnë këtë lloj kriminaliteti i mbrojnë delikuentët nga zbulimi dhe ndjekja e policisë, lirojnë nga akuzat, i shpëtojnë nga gjykimi ose u ndihmojnë që të dalin para kohë nga vuajtja e dënimit. Ndër veprat kryesore kriminale që kryejnë këto persona janë falsifikimet dhe transaksionet e ndryshme në bursat financiare, manipulimet në treg, marrja dhe dhënia e mitos, shmangia e pagimit të kontributeve dhe tatimeve, dhënia e lehtësimeve, e të tjera. Në botën bashkëkohore janë shumë raste dhe dukuri që tregojnë për kyçe dhe përzierje të personave të shquar në pushtet të cilët janë të përfshirë në aktivitete kriminele, ashtu siç janë të njohura: aferat, skandalet, dorëheqjet, arrestimet, gjykimet, etj. Prandaj dhe shpesh kemi raste kur kryeministrat, ministrat dhe funksionarë të tjetër të lartë shtetërorë japin dorëheqje përshkak të marrjes së mitos, për shkak të implikimit në afera dhe transaksione të ndryshme ilegale dhe kundërligjore.⁴⁰

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2001-2017 ka qenë nën udhëheqjen e kryeministrit Nikolla Gruevski me partinë e tij VMRO-DPMNE dhe bashkë me partinë shqiptare BDI me kryetar Ali Ahmetin, përgjatë kësaj udhëheqje periudha kur niveli i krimit dhe korrupsionit në shtet ka qenë në shkallët më të larta ka qenë në 2008-2017. Për këto dhjetë vite udhëheqje kanë ndodhur llojë llojë krimesh, duke filluar me manipulimin e procedurës së zgjedhjeve që është bërë nga këto dy parti, me qëllim që rezultati përfundimtar të jetë në favorë të tyre, ku ky manipulim doli në shesh përmes përgjimeve që u bënë publike më vonë nga partia LSDM me kryetar Zoran Zaev. Për këto manipulime të zgjedhjeve Prokuroria Speciale e RMV hapi një procedurë hetimi me emrin “Titanic” ku si i akuzuari kryesor për parregullsi të shumta elektorale ishte Kryetari i Komunës së Pustecit Edmond Temelko, por që përveç tij kishte të përfshirë edhe zyrtarë të tjerë të lartë. Përveç

³⁹ <https://www.kosova-sot.info/lajme/269607//>

⁴⁰ Ragip Halili “Kriminologjia”, Prishtinë, 2011, fq.139-141

manipulimit të zgjedhjeve, në këtë periudhë kanë qenë të identifikuar edhe krimet si: pastrami i parave brenda ministrive, keqpërdorimi i burimeve financiare dhe abuzimi me pagat e punëtorëve. Shkalla më e lartë e korrupsionit ndër vite është vërejtur në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve ku kanë abuzuar me buxhetin e projekteve të financuara nga fondet ndërkombëtare, madje edhe kur përmenden rastet specifike, si: ⁴¹

- Pastrami i parave të projekti “Shkupi 2014” ku u zbulua se për këtë projekt janë shpenzuar mbi 600 milion euro.

- Ndërtimi i autostradës Kërçov – Ohër e cila sipas Agjensisë së Rrugëve tregoi se ky projekt do të kushtojë rreth 270 milion euro, ndërsa qeveria e VMRO-DPMNE nënshkroi kontratë ndërtimi me një firmë kineze “Sinohydro” me vlerë 373 milion euro.

Kemi raste të tjera që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike, siç kemi: Rastin “Monstra” që është një rast i përshtatur politikisht për diktaturën e shtetit në marrëdhëniet ndëretnike, ku ky rast njihet nga vrasja e pesë të rinjë maqedonas afër liqenit të Smilkovacit dhe për këtë me urdhër të Ministris së Punëve të Brendshme që ishte në krye Gordana Jankullovskaja u bastisën dhunshëm shtëpiat e shqiptarëve, prej nga u arrestuan gjashtë shqiptar për burgim të përjetshëm si të dyshuarit kryesor për vrasje duke i quajtur shqiptarët si “Islamikë radikalë” dhe “Terroristë”. Rast tjetër është rasti i “Kumanovës” që është një ndër krimet ekstreme të organizuar nga qeveria e maqedonase e cila ka ndodhur në Kumanovë në “Lagjen e Trimave” ku u vranë tetë anëtarë të forcës ushtarake të Maqedonisë dhe dhjetë anëtarë të grupit të armatosur shqiptar dhe gjithashtu u arrestuan dyzet shqiptarë të dyshuar për pjesëmarrje në konflikt. Për këtë rast u dyshua kryeministri Nikolla Gruevski bashkë me agjentin e shërbimit sekret Sasho Mijalkov i cili ka paguar disa milion euro për nxitjen e një konflikti ndëretnik. Gjithashtu duke pasur parasysh se populli informohet nëpërmjet mediave, partia maqedonase kishin lidhje me televizionin Sitel dhe Kanal 5, të cilët jepnin lajme vetëm ato të cilët ofronin nxitje të tensioneve ndëretnike, ku për çdo rast të dhënë në lajme i akuzonin shqiptarët duke i quajtur terrorist. Përveç televizionit A1 i cili raportonte vazhdimisht periudhat e VMRO-së dhe çdoherë përballeshte me kërcënime pronësore, barriera dhe bojkotim të reklamave, ashtu dhe qeveria urdhëroi mbylljen e A1, ku ata përveç kësaj shkatërruan edhe të gjithë kapitalin e pronarit të

⁴¹ Ardita Abduli & Drita Mehmedi “ White Collar Crime in Republic of Macedonia in the Period 2008-2017” European Journal of Social Sciences, Tetovo, 2018, p. 178-183.

televizionit, Velia Ramkovski, të cilin edhe e burgosën duke e akuzuar për shpërdorim detyre dhe gjetje të shumë parregullsive në kompanitë e tij.⁴²

Rasti “Treqind” është një rast që ka të bëjë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare, ku një ndihmës ministër i Ministris së Punëve të Brendshme, u dyshua se kishte dëmtuar buxhetin e RMV-së për 453.570 euro, gjatë blerjes së 300 makinave për MPB-në. Rasti “Tifani” ka të bëjë me një person fizik i cili ka qenë pronar i “Smart Center SHPK eksport-import Shkup” dhe agjencisë “Smart”, ai ka dhënë fakte të rrejshme që kanë të bëjnë me llogaritjen e tatimit dhe duket që ndërrmarjet e tij i kanë ikur tatimit me vlerë prej 36.634 euro tatim, ndërkaqë i dyshuari nuk ka paguar tatim në vlerë prej 16.924 euro. Rasti “Tabela” është rasti kur drejtori i Shkollës Filllore “Rexho Rushi” nga fshati Zajas i shfrytëzoi kompetencat dhe ka mundësuar të mira materiale për ndërmarrjen “Bau Prof-Kiçevo” në vlerë 200 mijë euro. Rasti “Total” ka të bëjë me atë se një person për t’iu shmangur tatimit ka dhënë dëshmi të rrejshme dhe ka fshehur tatim prej 121.414 euro, i cili person ka qenë drejtues dhe pronar i agjencive për marketing “Total”, “Media Maks” dhe “Total Media Center”.⁴³

Rasti “Tank” është një tjetër rast ku është bërë keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe krimi ishte i kryer nga ana e ish ministres së Ministris së Punëve të Brendshme (MPB) Gordana Jankulovska dhe shefit të furnizimeve publike Gjoko Popovski, me çka i shkaktuan dëme të mëdha buxhetit shtetëror.⁴⁴

Rasti “Perandoria” është një tjetër rast ku i akuzuari ishte një biznesmen maqedonas Orce Kamçev i cili akuzohej për larje parash, keqpërdorim të detyrës dhe autorizimit të kreditorëve. Ku përveç tij të arrestuar ishin edhe partneri i tij në biznes dhe babai i ish Ministrit të Transportit dhe Lidhjeve Mile Janakieski, ku ky rast u quajt si i tillë përshkak një numri të madhë të përfshirë të personave që kryejn vepra penale si “shoqërim kriminel”.⁴⁵

Partia VMRO ishte e kapur fortë për institucionet shtetërore dhe veçanërisht tek ato gjyqësoret, prandaj dhe shteti u karakterizua si i kapur ndërsa institucionet si të robëruara. Kjo gjë u vërtetua pasi doli në shesh përmes përgjimeve i gjithë manipulimi i zgjedhjeve dhe krimeve të tjera të rënda që ishin kryer, por që edhe pas gjithë kësaj prokuroria e shtetit

⁴² Po aty.

⁴³ <https://portalb.mk/384658-larje-parash-ne-maqedoni-tabela-treqind-total-dhe-tifani-rastet-e-reja-te-ppsp-se-video/>

⁴⁴ <https://zaman.mk/al/aktuale/11885-gjykata-e-apelit-vendos-per-bombat-si-argumente-ne-rastin-tank.html>

⁴⁵ <https://portalb.mk/569351-rasti-perandoria-biznesmeni-orce-kamcev-u-dergua-ne-gjykate-videoarrestimi-i-biznesmenit-orce-kamcev-nga-ppsp-thone-se-ende-jane-ne-proces/>

refuzoi që t'i hetonte këto vepra dhe që t'i ndiqte penalisht, prandaj dhe u formua institucion special që të ndjekë pikërisht këto vepra penale që u publikuan nga përgjimet.⁴⁶

Dhe pas gjithë kësaj doli në sheshë edhe rasti “Reketi” që poashtu i akuzuar është një person zyrtar me pozitë të lartë dhe që ishte Prokurorja Speciale Publike Katica Janeva e cila u akuzua për mitëmarrje ashtu që në këmbim të pezullojë hetimet për një biznesmen, i cili është i përfshirë në pastrim parash dhe vepra tjera penale. Pasi që prokurorja e udhëheqte rastin “Perandoria” dhe për t’ia lehtësuar pozicionin të dyshuarit që ishte Orçe Kamçevi, ajo mori si shpërblim mobilje në vlerë prej 296.040 denarë dhe para në vlerë prej 50.000 euro.⁴⁷


Shumçka ka ndodhur në shtet për këtë periudh njëdekadësh, prandaj dhe mund të themi që ky shtet është qeverisur nga kriminelët apo thënë ndryshe nga mafiat më të mëdha, pasi që shihet se zyrtarët e pushtetit e vodhën në mënyrë massive vendin dhe që e kanë keqpëdorur, kanë manipuluar në mënyra nga më të ndryshmet, më të kqëijat vetëm e vetëm që të arrihet ajo se çfarë ato kanë pasur për qëllim. Prandaj nga të gjitha rastet e lartëpërmendura vërejtëm që kriminaliteti i “Jakës së Bardhë” në RMV ka qenë goxha i përhapur dhe që niveli i korrupsionit në vend ka qenë në një shkallë shumë të lartë për vite me rradhë, por që ne si qytetarë për gjitha këto nuk kemi pasur njohuri deri kur dolën përgjimet, prandaj dhe mund të themi që kjo gjë pra ky kriminalitet i organizuar nga zyrtarët e shtetit ka ndikuar shumë në përparimin dhe në zhvillimin ekonomik të vendit, gjithashtu mund lirëshët të themi që mos funksionimi i duhur i shtetit ka qenë edhe arsyeja kryesore që rinia jonë sot ka marr rrugët e perëndimit duke kërkuar atë që nuk e kanë pasur në vendin vetë, pra një jetë dhe një perspektiv më të mirë.

Ne në vazhdim do të shfaqim një figurë e cila do të na tregoj më qartë se si ka qenë nga viti 2008 deri në vitin 2018 numri i personave të cilët janë shpallur fajorë për arsye të shpërdorimit të detyrës.

⁴⁶ <https://portalb.mk/634551-na-ishte-nje-here/>

⁴⁷ <https://portalb.mk/681890-rasti-zhvatja-janeva-ka-paditur-boki-13-te-per-incizim-te-paautorizuar/>

Figura 1. Numri i personave të shpallur fajtor për shpërdorim detyre për periudhën 2010-2019



Nga kjo figure vërejmë që numri i personave të shpallur fajtor për shpërdorim detyre në RMV ka filluar nga 142 persona në vitin 2010 dhe ka rënë në vitin 2019 me 87 persona. Çdo vit dallon nga njëri tjetri por kulminacioni siç mund të shihet nga figura ka qenë në vitin 2014 me 243 persona, më pas përsëri me numër të lartë në vitin 2015 me 201 persona, por që më pas nga viti në vit ka vazhduar me rënie dhe që mund të thuhet se ka përmirësim të situatës për sa i përket personave që keqpërdorin detyrën zyrtare.

Sot mund të thuhet që me ndryshimin e pushtetit, krijimin e qeveris së re dhe me krijimin Prokurorisë Speciale në RMV, shteti ka përmirësim në kuptimin që ka filluar drejtësia të vihet në vend duke u dhënë dënimet e nevojshme për krimet e kryera, por që shpresojmë që kjo situatë të ketë një vazhdimësi të njëjtë ashtu që mos të fillojmë nga e para, pasi që pastaj do të jetë edhe shumë më e vështirë që të tejkalohen ngërçet ekonomike dhe politike në vend, si dhe do të jetë vështirë për të rifituar besimin e popullatës.

⁴⁸ http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat__Sudstvo/100_SK_ml_T-1.px/table/tableViewLayout2/?rxid=41dd7f7d-a7c5-4219-ba3b-cb448a775850

Kreu III

1. Ndërkombëtarizimi i korrupsionit

Ndërkombëtarizimi i korrupsionit ka implikime të thella për përpjekjet kundër korrupsionit, të cilat tradicionalisht kanë rënë nën mbikëqyrjen e politikës kombëtare dhe të bërjes së ligjit. Përhapja e korrupsionit në mënyrë transnacionale ka shkatërruar nocionin se korrupsioni është një çështje politike e brendshme e cila mund të trahtohet vetëm nga vendet individuale dhe perceptohet gjithnjë e më shumë si një problem i cili mund të trajtohet vetëm kolektivisht nga një qasje bashkëpunuese midis aktorëve ndërkombëtarë.

Çështjet e mitit dhe korrupsionit u sollën për herë të parë në rang ndërkombëtarë si rezultat i ngjarjeve që u bënë të njohura si “Skandali i Wetergate”. U kuptua që Presidenti Nixon kishte autorizuar një prishje të paligjshme në Hotelin Wetergate, Zyra e Këshillit Demokratik Kombëtar. Hetimi i këtij incidenti krijoi një nivel të lartë të ndërgjegjesimit të publikut në lidhje me sjelljen e dyshimtë të disa prej politikave të SHBA-së dhe biznes elitave dhe kjo çoi në hetime të mëtutjeshme për përfshirjen e korporatave në fushatat politike. Disa kompani u zbuluan se kishin kontribuar në mënyrë të paligjshme në fushatat politike të SHBA-së dhe gjithashtu kishin kanalizuar burime për qeveritë e huaja dhe partitë politike. Në disa raste kjo çoi që kombet e tjera të ndërmarrin hetimet e tyre të pavarura.⁴⁹

Iniciativa e parë për luftën kundër korrupsionit në fillim u zhvillua në nivel rajonal, ku marrëveshja e parë shumëpalëshe ishte Organizimi i Shteteve Amerikane në Konventën Amerikane Kundër Korrupsionit, në vitin 1996. Pastaj, lufta ndërkombëtare juridike kundër korrupsionit morri një vrull të madhë, me Konventën e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) duke e luftuar ryshfetin apo mitin e zyrtarëve të huaj publik në transaksionet e Biznesit Ndërkombëtar në vitin 2001 dhe marrëveshja e parë globale, ka qenë Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), në vitin 2005.

⁴⁹ Clare Fletcher & Daniela Herrmann “The internationalization of Corruption – Scale, impact and countermeasures”, Britania, 2012, p. 1 & 58-59.

2. Korrupsioni si pengesë për integrimin e RMV në BE

Për shumë vende të botës korrupsioni paraqet një dukuri problematike që u shfaqë atyre shumë shqetësime, sidomos vendeve demokratike, prandaj dhe është shumë me rëndësi që të luftohet kjo dukuri pasi që ajo bëhet një pengesë për demokracinë, për zhvillimin e vendit, për zbatimin e ligjeve të tij dhe për gjithçka tjetër që ai vend pretendon apo shpreson që të arrijë. Kështu dhe duke patur parasysh që Maqedonia është në rrugën e integritit drejtë për në Bashkimin Europian, ajo duhet që të zgjedhë problemin kryesor që është lufta kundër korrupsionit ashtu që të mos i shfaqet pengesë përgjatë këtij rrugëtimi.

Korrupsioni jo vetëm që parandalon por edhe ngadalëson ndjeshëm reformat politike dhe ekonomike në të gjitha vendet, veçanërisht në vendet në tranzicion. Raporti i Komisionit Evropian I paraqitur në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, për kandidatët për anëtarësim në BE tregon që kanë pasur shumë pak përparim në drejtim të korrupsionit, të cilin konkluzion komisioni e nxorri në bazë të analizave të bëra nga Banka Botërore, OECD (organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim) dhe organizata të tjera ndërkombëtare që ishin aktive në lidhjen me çështjen e parandalimit të korrupsionit. Analizat e vendeve në tranzicion çuan në fakte të pakundërshtueshme që “manjanët” ushtrojnë ndikim të rëndësishëm tek politikanët, gjyqësorët dhe organet tjera shtetërore për të miratuar zgjidhje ligjore të cilat do të lehtësojnë fshehjen e veprimtarive të tyre korruptive. Për shembull, në vendet në tranzicion, egziston një praktikë e zakonshme e “manipulimit” të shitjes së kompanive gjatë procesit të privatizimit. Kontrolli institucional qeverisës rezultoi të ishte joadekuat në shumicën e vendeve. Raporti i Kordinatorit Ekzekutiv (KE) gjithashtu tregoi se shumica e deputetëve kanë mungesë ndërgjegjësimi për kompetencat dhe përgjegjshmërinë e tyre, si dhe njohuri të pamjaftueshme në lidhje me problemet me të cilat qeveria duhet të merret.⁵⁰

Në Maqedoninë e Veriut korrupsioni është i përhapur nëpër të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe ajo bënë pjesë në grupin e vendeve me shkallë të lartë korrupsioni. Prandaj dhe ajo ka krijuar Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit si organ që duhet t’i luftojë dukuritë negative ashtu që të mund edhe të arrijë të bëhet anëtare e BE-së. Por lufta e kësaj dukurie mund të jetë edhe më e suksesshme nëse mundohen të gjithë së bashku si: autoritetet qeverisëse, organizata të shoqëris civile dhe subjektet ekonomike private, ku nga

⁵⁰ Rade Bogojevic & Tatjana Skakavac “Corruption as an obstacle to European Integrations”, Serbia, 2018, fq.60-61.

të gjitha përpjekjet vendi të mund të bëjë ndryshime në zakonet e këqija dhe do të mund të zhduk apo të minimizojë korrupsionin dhe të arrijë qëllimin për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian.

3. Harmonizimi i legjislacionit të RMV me të drejtën e BE

Maqedonia e Veriut është një vend që kandidon për t'u anatarësuar në Bashkimin European, prandaj dhe është në process të harmonizimit të legjislacionit të vendit me ligjin apo të drejtën e BE-së. Tek kjo pjesë e punimit ne do të përqendrohemi në prezantimin dhe shpjegimin e kushtetues aktuale dhe baza të tjera të vlefshme ligjore për zbatimin e drejtëpërdrejtë dhe indirekt të ligjit të BE-së në rendin juridik maqedonas në periudhën para antarësimit dhe veçanërisht në identifikimin e tendencave kryesore në zbatimin e tij në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme të RMV-së. Pasi dimë që Maqedonia nuk është si vend ende antare e BE-së kuptohet që ajo ende nuk ka të përcaktuar një bazë të qartë në Kushtetutën e saj për zbatimin e ligjit të BE-së. Zbatimi i drejtëpërdrejtë dhe i tërthortë i ligjit të Bashkimit para antarësimit në BE duhet të dallohet kryesisht nga dispozitat përkatëse kushtetuese dhe statute për statusin dhe efekti i traktateve ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë zbatueshmërinë e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit, Marrëveshjet e tjera lidhur me BE-në dhe Marrëveshjet e përgjithëshme ndërkombëtare.⁵¹

Nga këndvështrimi juridik, në periudhën e para-pranimit, si çdo kandidat tjetër shtetëror për antarësim në BE, Republika e Maqedonisë së Veriut e gjen veten dukshëm në një situatë të panatyrshme. Nga njëra anë procesi i vazhdueshëm i harmonizimit të legjislacionit të tij kombëtar me të drejtën e Bashkimit Evropian të cilit gjithashtu i ekspozohet edhe RMV si pjesë e procesit të kushtëzuar para-antarësimit, shkakton depërtim të përleshëm dhe progresiv të një numri të konsiderueshëm të rregullave juridike të BE-së në legjislacionin e tij kombëtar. Më vonë sugjerohet një urgjencë e padyshimtë për të siguruar një efekt adekuat juridik për këto rregula të BE-së Brenda rendit juridik të brendshëm. Nga ana tjetër, në periudhën e para-antarësimit në parim nuk ka asnjë detyrim zyrtar të parashikuar në mënyrë të qartë për gjykatat e vendeve candidate të zbatojnë ligjin e BE-së edhe pse gjykatat kombëtare kanë një zgjidhje sipas gjykimit të caktuar për t'u dhënë burimeve ligjore të Be-së disa aftësi për të prodhuar implikime ligjore brenda sistemit

⁵¹ Saso Georgievski "Application of the Law of the European Union in the Republic of Macedonia", SEELS, 2014, p. 99-130.

juridik të vendit. Sidoqoftë, mund të ndodhë vetëm Brenda kornizës legale e ofruar nga rregullat përkatëse kushtetuese vendase në zbatueshmërinë e së drejtës ndërkombëtare në rendin e brendshëm juridik dhe nga rregulla të tjera ligjore përkatëse.⁵²

Kodi penal i Maqedonisë së Veriut inkriminon veprat penale të mëposhtme: marrja e mitos, dhënia e mitos, marrja dhe dhënia e mitos në lidhje me votimin, shpërdorimi i pozitës së një personi përgjegjës, keqpërdorimi i prokurorit publik, shkelja e të drejtave të punsimit dhe gjatë papunësisë, abuzimi i pozitës zyrtare dhe pastrami i parave.

Veprat penale si keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimi zyrtar konsiston në veprën penale të kryer nga personi zyrtar i cili abuzon me pozitën dhe autorizimet e veta zyrtare për përfitime personale apo në dobi për tjetrin ose në dëm të tjetrit. Në këtë vepër veprimi i kryerjes konsiston në: a) keqpërdorimin e pozitës zyrtare b) tejkalimi i autorizimeve të veta; c) moskryerja e detyrave zyrtare.⁵³

Sistemi Juridik i Maqedonisë ofron baza të mjaftueshme legale për të zbatuar burimet ligjore të caktuara të BE-së gjatë fazës para-antarësimit të vendit, përfshirë edhe aplikimin për 'Euro' të legjislacioni i vendit në dritën e burimeve përkatëse të ligjit të BE-së. Fillimisht, baza të tilla juridike mund të gjenden në normat e përgjithëshme kushtetuese që rregullojnë zbatueshmërinë e burimeve të së drejtës ndërkombëtare, e cila kuptohet si konvergjente ose njohëse e burimeve të së drejtës.⁵⁴

4. Korrupsioni në Maqedoni

Indeksi i Perceptimit të korrupsionit merr vlerat zero për vendet shumë të korruptuara dhe 100 për vende të pakorruptuara. Ky indeks i rendit vendet sipas perceptimit se sa i korruptuar mendohet që është sektori publik dhe kjo renditje tregon pozicionin e çdo vendi të cilën e krahasojmë me vendet e tjera, ku mund të shihet më qartë se cili vend është më shumë dhe më pak i korruptuar, ku kuptohet që vendi që ka renditje më të lartë perceptohet si vendi më i korruptuar.

⁵² T. Petrushevska, I. Cenevska, N. Stamenkovic & M. Stojanovski "European Union Law Application in the Republic of Macedonia Before Its Accession to the EU", Skopje, January, 2012.

⁵³ Zejneli, I., E drejta penale, Pjesa e posacme, 2007, faqe 151

⁵⁴ Saso Georgievski "European Union Law Application in the Republic of Macedonia Before its Accession to the EU", Skopje, 2012, p.17.

Tabela 3. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit në Maqedoni

Maqedonia		
Vitet	Renditja	Pikët
2010	62	41
2011	69	39
2012	69	43
2013	67	44
2014	64	45
2015	66	42
2016	90	37
2017	107	35
2018	93	37
2019	106	35

Burimi: Autori

Tabela na tregon se në cilin vend renditet Maqedonia për sa i përket Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit, ku përveç renditjes kemi paraqitur edhe pikët që janë llogaritur për korrupsion në Maqedoni për dhjetë vitet e fundit, prej vitit 2010 deri në vitin 2019. Ajo që mund të shihet qartë është se Maqedonia në vitin 2010 ka pasur një renditje më të mirë pra me më pak korrupsion me 41 pikë, në krahasim me vitet tjera që pothuajse për çdo vit ka pasur rritje dhe viti me korrupsion më të lartë për Maqedoninë ka qenë viti 2017 me 35 pikë. Por që edhe pas kësaj shihet që në dy vitet e fundit renditja e Maqedonisë lidhur me korrupsionin është përmisuar, por që ende është një ndër vendet me korrupsion më të lartë.

Këtë vit Maqedonia e Veriut renditet 13 vende më poshtë se vitin e kaluar. Dhe kjo për ekspertët e antikorrupsionit është vetëm një e vërtet dhe dëshmi se sistemi është tejet i brishtë. Rasti “Zhvatja”⁵⁵ cilësohet nga më të rëndët në Maqedoninë e Veriut. Prandaj dhe për këtë kryetarja e Antikorrupsionit Biljana Ivanovska ka thënë që: "E dini se pas rastit “Zhvatja” perceptimi për korrupsionin në vendin tonë është rritur. Mirë do të ishte që ky

⁵⁵ “Zhvatja” – njihet si kërkim i një ryshfeti apo miti nga një zyrtar si një kusht për të kryer detyrën e tij, ose për të shkelur ligjin. Kurse rasti “Zhvatja” në Maqedoni ka të bëjë me një skandal korrupsioni prej qindra mijë eurosh në të cilën është e përfshirë prokurorja Katica Janeva.

rast të zgjidhet në mënyrë që të kthehet besimi tek institucionet. Nëse gjyqësori e bënë punën e tij, nuk do të kemi kësi llojë perceptimi".⁵⁶

Tabela 4. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për vendet e Ballkanit perëndimor

Korrupsioni për vendet e Ballkanit perëndimor	
Vendi	Renditja sipas indeksit të IT (2019)
Shqipëria	35 pikë vendi 106
Bosnia dhe Herzegovina	36/101
Kosova	36/101
Maqedonia e Veriut	35/106
Mali i Zi	45/66
Serbia	39/91

Burimi: Autori

Mund të shohim edhe nga tabela e cila na tregon që nga vendet e rajonit Maqedonia është më keq se Bosnja, Kosova, Serbia dhe Mali i Zi, dhe ndodhet në pozitë të njejtë me Shqipërinë. Gjendje më të mirë nga këto vende ka Mali i Zi e cila renditet në vendin e 66 me 45 pikë.

Në vazhdim do të paraqesim një tabelë e cila do të na jap një pasqyrë për totalin e veprave penale të raportuara për persona të rritur dhe të dënuar në RMV nga periudha 2010-2019. Të dhënat tona në këtë tabelë i kemi marrur nga Zyra e Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

⁵⁶ <https://euronews.al/al/maqedoni-e-veriut/2020/01/23/korrupsioni-ne-maqedonine-e-veriut-humbet-13-vende-ne-krahasim-me-vitin-e-kaluar>

Tabela 5. Personat e raportuar dhe të dënuar për të gjitha llojet e krimeve në RMV për periudhën 2010-2019

Vitet	Raportuar	Dënuar
2010	30.004	9.169
2011	31.284	9.810
2012	31.860	9.042
2013	34.436	9.539
2014	37.164	11.683
2015	26.069	10.312
2016	20.502	8.172
2017	20.582	6.273
2018	19.779	5.857
2019	12.255	4.712

Burimi: Makstat baza e të dhënave⁵⁷

Nga Tabela shohim që numri i personave të raportuar dhe të dënuar për të gjitha llojet e krimeve nga viti 2010 deri në vitin 2014 ka qenë vazhdimisht në rritje, ndërsa prej vitit 2015 e deri në vitin 2019 shihet që ka filluar tendenca e uljes dhe që numri i personave të raportuar nga viti 2010 në vitin 2019 ka rrënë prej 30.004 në 12.255 persona dhe ato të dënuar nga 9.169 në 4.712 persona.

Në Shtojcën 2 mund të shihni më qartë se si ka qenë numri i personave të dënuar nga viti 2010 deri në vitin 2019 nëpër të gjitha llojet e krimeve veçmas, ku shumë qartë shihet që numri më i lartë i personave të dënuar ka qenë tek krimet kundër pronës dhe tek krimet kundër sigurisë së komunikacionit.

Në vazhdim do të japim një tabelë ku do të shohim se si është perceptimi i qytetarëve për përhapjen e korrupsionit nëpër profesione.

⁵⁷ http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat__Sudstvo/100_SK_ml_T-1.px/table/tableViewLayout2/?rxid=1727abf2-5f75-40d7-b2da-905bd124e744

Tabela 6. Perceptimi qytetarëve për përhapjen e korrupsionit nëpër profesione

	rrallë është përfshirë dikush	shumica janë të përfshirë	disa janë të përfshirë	pothuajse të gjithë janë të përfshirë
inpektorët e taksave	5.2%	47.8%	21.7%	25.3%
zyrtarët e universitetit ose profesorët	7.6%	47.8%	30.3%	14.3%
prokurorët publik	4.0%	46.7%	19.2%	30.0%
zyratrë në ministri	8.2%	46.5%	30.3%	15.0%
gjyqtarët	3.3%	45.8%	15.7%	35.1%
gazetarët	9.0%	45.3%	31.9%	13.9%
anëtarët e këshillit komunal	10.3%	44.5%	26.7%	18.5%
mjekët	10.2%	43.4%	32.5%	14.0%
hetuesi (personi që kryen procedurën e hetimit)	9.5%	43.1%	22.6%	24.8%
biznesmenët	4.6%	42.9%	27.8%	24.8%
zyrtarët administrativë në sistemin gjyqësor	11.2%	42.4%	32.7%	13.7%
oficerët doganor	5.3%	42.3%	20.9%	31.6%
avokatët	9.0%	41.5%	22.7%	26.8%
oficerët e policisë	8.4%	41.4%	31.6%	18.6%
anëtarët e parlamentit	5.4%	40.7%	17.4%	36.5%
udhëheqësit politikë lokal	4.0%	40.6%	21.8%	33.7%
ministrat	3.2%	40.6%	18.7%	37.6%
zyrtarët komunal	12.4%	40.3%	34.3%	13.1%
drejtuesit e partive politike dhe të koalicioneve	2.1%	38.7%	21.5%	37.7%
kryetarët e komunave	5.4%	35.0%	18.8%	40.8%
përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile	14.7%	34.6%	32.3%	18.4%
bankierë	21.8%	34.0%	33.3%	10.9%
mësuesit	33.5%	27.6%	32.9%	6.0%

Burimi: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar⁵⁸


Nga Tabela shohim që shumica e qytetarëve mendojnë që gjyqtarët dhe prokurorët publik janë ndër më të korruptuarit nga profesionet e lartëpërmendura dhe më pas deputetët, ministrat, liderët e partive politike dhe udhëheqësit lokal gjithashtu janë profesionet më të korruptuar dhe një pjesë e mirë e tyre besojnë që korrupsioni ka

⁵⁸ <https://mcms.mk/images/docs/2020/izveshtaj-za-procena-na-korupcijata-vo-severna-makedonija-2020.pdf>

depërtuar edhe në doganë dhe në administrate tatimore. Ndërsa për bankierët dhe për mësuesit dhe të gjitha profesionet e tjera të listuara qytetarët i shohin si profesione më pak të korruptuar.

Tani për këto profesione në vazhdim do të japin një figure e cila do të na tregojë se për disa vite me rradhë si ka qenë perceptimi i qytetarëve, ku do të shohim më qartë në qoftëse mendimi i tyre ka ndryshuar për vite pra nga viti 2001 deri në vitin 2019, apo mbeten me mendimin që këto profesione vazhdimisht janë ndër më të korruptuarit.

Figura 2. Perceptimi i korruptimit në profesione - më të korruptuarit



Burimi: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Këtu në figure kemi paraqitur profesionet si më të korruptuara nga shkalla 1 deri në 4, ku shkalla 1 tregon se gati asnjë nuk është i përfshirë dhe 4 që tregon se gati çdokush është i përfshirë. Dhe tani mund të shohim që për vite me rradhë këto profesione janë perceptuar si më të korruptuarit, prandaj dhe vërehet nga viti 2001 deri në vitin 2019 një rritje e vazhdueshme të perceptimit të korrupsionit në këto profesione sidomos në prokurorinë publike dhe tek gjyqtarët, ku ka lëvizur nga 2.7 në 3 për prokurorinë publike dhe për gjyqtarët nga 2.8 në 3.1.

5. Dhënia e mitos

Ryshfeti apo mitoja është një nga format më të vjetra të korrupsionit, është një krim që kryhet në detyrë, me qëllim përfitimi duke shkelur detyrën dhe besimin e ngarkuar, prandaj dhe është i përfshirë pikërisht në grupin e krimeve kundër autoritetit të shtetit. Esenca e kësaj vepre penale qëndron në atë, që ofiqari qëllimisht mer nga persona të tretë apo organizata shpërblime të paligjshme materiale për sjelljet apo veprimet e tij zyrtare, apo që lidhen me postin që ai ka.⁵⁹

Dëmi që sjell kjo vepër penale, paraqet rrezikshmëri shoqërore të lartë, duke e dëmtuar rëndë besueshmërinë e shtetasve ndaj efikasitetit të shtetit të tyre dhe ulë autoritetin e tij, gjë që ndikon direkt në ndërgjegjen shoqërore. Këto vepra penale shfaqen në disa forma si:

- Mitet paguhet për të hyrë në një përfitim ose për të shmangur shpenzime, ku në çdo vendim të ofiqarit fitimi nga mitot është humbje e dikujt (liçenca për leje aktiviteti, privatizimi, blerja e trojeve apo ndërmarrjeve publike, etj).
- Mitet jepen për përfitime ose evitim shpenzimesh atje ku mund të përdoret autoriteti i nëpunësve shtetrorë (reduktimi i faturave, leje për projekte ndërtimi, heqja dorë nga taksat, etj)
- Mitet mund të jepen jo për ndonjë përfitim publik specifik, por për shërbime që lidhen me sigurim përfitimesh apo evitim shpenzimesh (reduktimi i procedurave paraprake, rritja e shpejtësisë në shërbime, njoftimet paraprake të kriminelëve se do të goditen nga policia, etj.)
- Mitoja mund të paguhet për të penguar ndarjen e përfitimeve me të tjerët apo për t'i paguar një kosto të caktuar dikujt tjetër (monopolizimi i biznesit, kërkesa për të shtuar kufizimet ndaj konkurentëve, etj).

Dhënie dhe marrja e mitos kalon nëpër disa faza, të cilat janë në varësi të rangut të ofiqarit si dhe mënyrës së realizimit, siç kemi:⁶⁰

- Dhënia e mitos direkt nëpërmjet dhënësit dhe marrësit
- Dhënia e mitos nëpërmejt personave të ndërmjetëm apo siç quhen rëndom në gjuhën e popullit „sekserë“.

⁵⁹ Prof. Luan Gjonça “Korrupsioni – veprat penale përbërëse, krimi i organizuar”, Tiranë, 2004, fq.141-148.

⁶⁰ Po aty.

Dhënia e mitos shfaqet në disa forma siç janë:

- Dhënia e mitos në formën e huasë
- Kredive
- Borxhit
- Shlyerjes së borxheve të vjetra
- Nëpërmjetë dhënies së mundësis për shitje dhe blejre të sendeve me vlerë

me çmime më të ulëta


- Nëpërmjet shpërblimeve
- Pagave dhe rrogave fiktive
- Çmime nga shoqata apo fondancione, etj.

Kërkimi për dhënie mite në Kodin Penal të RMV-së pasqyrohet në brendinë e nenit 358, në të cilin thuhet: “Ai i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë i jep ose i premtun një dhuratë ose përfitim tjetër me qëllim që t’i kryej brenda autoritetit të tij zyrtar disa punë zyrtare që nuk duhet të kryhen ose mos kryerja e ndonjë akti zyrtar që duhet të kryhet ose ai që ndërmjetsonë në këtë, do të dënohet nga 1 deri në 5 vjetë burgim.”⁶¹

Në vazhdim do të paraqesim një figurë e cila tregon se si është dhënia e mitos në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku do të shohim shumë qartë se cilët vende kanë dhënie më shumë të mitos dhe më pak.

⁶¹ <https://www.pravdiko.mk/ep-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>

Figura 3. Dhënia e mitos në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019




Burimi: SELDI Corruption Monitoring System, 2019.⁶²

Në Figurën 3 ne kemi paraqitur mitëdhënien për Vendet e Ballkanit Perëndimor si: Bosna dhe Hercegovina, Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Dhe nga kjo figurë, mund të shohim që nga këto vendet Maqedonia e Veriut na paraqitet me një përqindje 23% që është më e vogël në krahasim me vendet tjera dhe pastaj vijonë me Serbinë e cila pothuajse është e përafert me MV që është 26%, ndërsa prej vendeve tjera mund të shihet shumë qartë që vendi që ka më shumë dhënie të mitos është Bosna dhe Hercegovina me 48%.

⁶² SELDI.net. "Corruption in the Western Balkans 2019: Trends and Policy Options", 2019. https://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/Policy_Brief_9/SELDI_PB_09_Corruption_in_the_Western_Balkans_2019.pdf

Në vazhdim do të shfaqim një figurë tjetër e cila do të na tregoj se si është numri i personave të dënuar për mitëdhënien dhe mitëmarrjen në RMV për periudhën 2010-2018.

Figura 4. Numri i personave të shpallur fajtor për mitëdhënie dhe mitëmarrje për periudhën 2010-2018



Burimi: Qendra Maqedonase Për Bashkëpunim Ndërkombëtar ⁶³

Nga Figura mund të shohim që numri i personave të dënuar për mitëmarrje ose mitëdhënie është shumë i vogël, pasi që shihet dukshëm se ka pasur zvoglimë të numrit nga viti 2010 ku numri ka qenë në 20 persona deri në vitin 2018 ku numri ka rënë në 3 persona.

⁶³ <https://mcms.mk/images/docs/2020/izveshtaj-za-procena-na-korupcijata-vo-severna-makedonija-2020.pdf>

6. Marrja e mitos

Karakteristik e mitit është se ai shpesh herë përdoret për të krijuar kushte apo mundësi për zhvillimin e veprimtarive të tjera kriminale dhe marrësi i mitos nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të tij lejon zhvillimin e një aktiviteti tjetër kriminal apo e kamuflon atë.⁶⁴

Marrja e mitos nga ofiqari pa shpërblim apo me çmime të reduktuara mund të paraqitet në disa forma:

- Pushimet në vila e kampe pushimi
- Udhëtime të ndryshme të karakterit turistik
- Dhënia e lëndës së parë pa pagesë
- Dhënia e garancisë për të “fituar”, në konkurset e shkollave
- Specializime
- Sistemime në punë, etj.

Në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut për këto vepra penale parashikohen dënime të ndryshme që variojnë nga gjoba deri në 4-10 vjetë për marrje dhe dhënie të mitos.


Marrja e mitës parashikohet në brendinë e nenit 357 të Kodit Penal të RMV-së, në të cilën thuhet: “personat zyrtar që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë pranojnë ose kërkojnë dhurata ose përfitime të tjera për vete ose për person tjetër ashtu që të kryej brenda autoritetit të tij zyrtar një akt zyrtar ose të mos lejoj kryerjen e ndonjë vepre zyrtare që duhet të kryhet, do të dënohet me burgim nga 4 deri në 10 vjetë.”⁶⁵

Në vazhdim do të japim një figure e cila tregon se si është mitëmarrja për vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019.

⁶⁴ Prof. Luan Gjonça “Korrupsioni – veprat penale përbërëse, krimi i organizuar”, Tiranë, 2004, fq.148.

⁶⁵ <https://www.pravdiko.mk/ëp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>

Figura 5. Marrja e mitos në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019




Burimi: SELDI Corruption Monitoring System, 2019

Mitëmarrja apo presioni për korrupsion ka mbetur i lartë në të gjithë rajonin në vitin 2019. Figura jonë tregon që Serbia ka mitëmarrje me 27% ku edhe pse ka panairin më të mirë në Ballkanin Perëndimor ajo jep rezultate që janë dy herë më të këqija se performuesi më i keqë që është anatarë i BE-së në të njëjtin vit. Maqedonia është me 29%, Kosova me 31% ku mund të thuhet se këto dy vende kanë një përqindje të përafërt, por me Shqipërinë Maqedonia ka një dallim shumë të madhë që është diku rreth 15%.

Më tutje ne do të vazhdojmë të tregojm për mitëmarrjen po në këto vende të Ballkanit Perëndimor por me një krahasim për vitin 2014, 2016 dhe 2019, ku do të shohim se si ka lëvizur, nëse vendet kanë pasur përmisim pra nëse është zvogëluar ose është rritur mitëmarrja dhe sa është diferenca e saj prej vitit 2016 e deri në vitin 2019.

Figura 6. Marrja e mitos në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitet 2014, 2016 dhe 2019



Burimi: SELDI Corruption Monitoring System, 2019

Rrezultatet për të krahasuar dinamikën e korrupsionit midis viteve 2014 dhe 2019 demonstrojnë përhapjen alarmante të korrupsionit në Ballkanin Perëndimor. Në figurën 3 që tregon krahasimin e mitëmarrjes, shohim që për vitin 2019 nga vendet Ballkanike më shumë mitëmarrje ka Bosna dhe Herzegovina me 55% dhe mëpas asaj i afrohet Shqipëria me 45%. Nëse e vërejm mirë shohim që Shqipëria në vitin 2014 ka qenë po në të njëjtën gjendje që ka qenë në vitin 2019 por që në vitin 2016 ajo ka qenë edhe më e lartë me 50%. Gjithashtu edhe Maqedonia e Veriut ka lëvizur nga 26% në vitin 2014 me 30% në vitin 2016, ndërsa në vitin 2019 ka pasur një diferencim me 1 % nga viti 2016 që është 29%. Serbia dhe Kosova pothuajse kanë një përqindje të përafërt dhe prej vitit 2014 deri në vitin 2019 ato kanë lëvizur duke u rritur përqindja e mitëmarrjes. Mali i Zi shihet që mitëmarrje më të ulët ka pasur në vitin 2016 me 22% dhe nëse e krahasojmë me vendet tjera për këtë vit shohim që është një vend me më pak mitëmarrje për vitin përkatës.

Pra në përgjithësi nga ajo që pamë në figurë mund të thuhet që mitëmarrja po rritet në katër nga gjashtë vendet e rajonit, pasi shihet që në Maqedonin e Veriut dhe në Shqipëri ka pasur një rënie. Përqendërimi më i lartë i këtyre vendeve në pritjen e fillimit të negociatave të pranimit mund të kenë kontribuar në rezultate më pozitive. Ndërsa vendet që kanë shkuar mbrapa janë Mali i Zi dhe Bosna dhe Hercegovina, ku kjo e fundit garantonë vëmendjen e vet, këto demonstrojnë një dobësi të përparimit të arritur dhe kjo bënë një thirrje për angazhim të vazhdueshëm me të gjithë vendet e rajonit.⁶⁶

⁶⁶ SELDI.net. "Corruption in the Eastern Balkans 2019: Trends and Policy Options", 2019. https://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/Policy_Brief_9/SELDI_PB_09_Corruption_in_the_Eastern_Balkans_2019.pdf

Kreu IV

1. Masat parandaluese të korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit nuk është një detyrë që i takon vetëm qeverisë ose vetëm një sektori të veçantë, por ajo është një detyrë që duhet të kryhet me ndihmën e të gjithë sektorëve që e përbëjnë shoqërinë e vendit. Edhe pse është thënë që korrupsioni është si një kancer që prek shoqërinë, ne e dimë që nëse e zbulojmë në kohë dhe nëse trajtohet me masat e duhura dhe në duart e personelit të specializuar, është e mundur që të e kapërcejmë atë.⁶⁷

Korrupsioni paraqet një mosfunksionim të sistemit që buron dhe prek sistemin legjislativ, institucional dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore specifike për institucionet sociale. Si një fenomen kompleks që është, ai kërkon metoda speciale të parandalimit duke marrë parasysh të gjitha ato të përshtatshme ligjore, si dhe ato administrative. Masat për parandalimin e korrupsionit duhet të jenë më të ndryshmet, siç janë legjislacioni, administrata, si dhe masat me karakter shoqëror, etj. Zhvillimi i një strategjie efektive për antikorrupsion kërkon para së gjithash zgjedhjen e rregullave që përcaktojnë udhëzimet kryesore për veprim, masa, përgjegjësi dhe burime.⁶⁸

Korrupsioni është një fenomen që duhet të frenohet në kohën e duhur përndryshe ajo karakterizohet me një përhapje të shpejtë dhe si një epidemie sociale, prandaj për të parandaluar këtë dukuri është e domosdoshme përgaditja në kohë dhe marrja e masave të karakterit profilaktik afatëgjatë ku përfshihen edhe politikat e antikorrupsionit. Ku këto politika varen nga efektiviteti dhe funksionimi i shtetit në njohjen e situatës dhe të faktorëve përkatës.⁶⁹ Masat e politikave të antikorrupsionit janë disa si:

- **Masat e karakterit legjislativ** – nuk është e thënë të ketë perfeksionizëm në legjislacion mirëpo kur ka mungesë të tyre atëherë egzistojnë mundësi për lindje të korrupsionit, prandaj dhe kjo është një ndër masat që duhet të ndërmerret për të luftuar korrupsionin duke e rishikuar legjislacionin egzistues dhe duke krijuar ligje të reja të veçanta në lidhje me korrupsionin të cilat do të rregullojnë marrëdhëniet në sferën e shërbimit shtetëror.

⁶⁷ "La Corruption : Características y consecuencias en Republica Dominicana", Marzo, 2003.

⁶⁸ Ismail Zejneli "Corruption as a form of Organized Crime", International Journal of Humanities and Social Science, Tetovo, 2014, p. 103.

⁶⁹ Prof. Luan Gjonça "Korrupsioni – veprat penale përbërëse, krimi i organizuar", Tiranë, 2004, fq.261-300.

- **Masat organizative** - këtu evidentohen masat që merren në drejtimet më të vështira që janë ato të parandalimit të korrupsionit dhe kompromentimit të nënpunësve të administratës publike qendrore apo atyre vendore, nga ku për të realizuar këtë qëllim duhet që të fillohet nga formulimi i koncepteve e praktikave të drejta për rekrutimin në shërbimet publike të njerëzve të ndershëm me vendosjen e kërkesave të forta për marrjen e tyre në punë. Ndërsa një gjë tjetër e rëndësishme e cila kërkon kohë dhe është e vështirë për tu realizuar është brumosja e këtij koncepti në vetëdijen shoqërore të opinionit publik e cila realizohet nëpërmjet një kompleksi masash organizativo-politike e ndër to është edhe vënia në funksionim të “Kodeve Morale,” respektive të sjelljes, ku përfshihen norma e rregulla të detyrueshme sjelljeje për bashkësi të ndryshme zyrtarësh.

- **Rritja e informacionit publik dhe inkurajimi i shoqërisë civile** – është një nga kërkesat kryesore në angazhimin e luftës së korrupsionit dhe materializohet në përmirësimin e komunikimit midis institucioneve dhe publikut në tërësi, sidomos në drejtim të çështjeve të tilla si identifikimi më i mirë i problemeve të ngritura nga publiku dhe marrja e masave për zgjedhjen e tyre në kohë, vënien në jetë të programeve për informim të publikut, rritja e bashkëpunimit me koalicionet dhe shoqata që luftojnë korrupsionin, edukimin e komunitetit dhe biznesit si dhe rritja e transparencës në realizimin e shërbimeve publike të tjera.

- **Promovimi i transparencës dhe integriteti në operacionet e biznesit** – këtu merren masa të cilat kanë të bëjnë me transparencën e veprimtarisë së biznesit që përfaqëson edhe pikën më të dobët të mundësisë së zhvillimeve korruptive. Të cilat mund të ishin: transparenca e procedurave administrative mbi biznesin, thjeshtësimi i procedurave administrative mbi biznesin për të parandaluar mundësit për korrupsion, parashikimi i përgjegjësive të mjaftueshme penale, civile dhe administrative për kompanitë e biznesit, nëpunësve publik të vendit dhe të huaj, poashtu edhe përmisimin e kornizës ligjore brenda transaksioneve të biznesit duke evidentuar efektin e instrumenteve përkatës antikorrupsion.

- **Menaxhimi i financave publike dhe mekanizmat e kontrollit**⁷⁰ –për menaxhimin financiar të sistemit mungojnë aktet që përcaktojnë standardin dhe kontrollin cilësor të përgjegjësisë, e njëjta gjë mund të thuhet për sistemin e kontrollit të brendshëm ku jo vetëm që mungon tradita por mungojnë edhe standardet apo manuale të detajuara me

⁷⁰Po aty.

praktikat ndërkombëtare në këtë drejtim. Prandaj disa strategji për parandalim të korrupsionit në menaxhim të financave publike janë ato si: përmirësimi i planifikimit të buxhetit, të adaptohet legjislacioni sekondar në nivelet bashkëkohore për zbatimin e ligjit mbi buxhetin organik, përsosja e strukturave të Ministrisë së financave sipas kërkesave bashkëkohore, rritja e kontrollit dhe shkallës së verifikimit të transaksioneve taksapaguese për të identifikuar dhe mbajtur në kontroll nivelin e evazionit fiskal dhe korrupsionit.

- **Bashkepunimi ndërkombëtar** – korrupsioni është një problem ndërkombëtarë pasi ai prek të gjitha vendet e botes, prandaj dhe bashkepunimi me komunitetin partner ndërkombëtar kthehet në prioritet për çdo shtet jo vetëm për anën protokollare të kësaj marrëdhënie se sa për zgjedhjet dhe mundësitë efektive që ofron komuniteti, sidomos në drejtime të tilla si krijimi i një infrastrukture ligjore si dhe në sferën e koordinimit dhe bashkëpunimit ku interesi është i dyanshëm mbasi dihet se në çdo vepër korruptive në marrëdhëniet ndërkombëtare çënohen drejtëpërdrejt edhe interesat e komunitetit ndërkombëtar.

Kështu me të gjitha masat e lartëpërmendura nëse i përdorim ato në mënyrën e duhur është shumë më e lehtë rruga drejtë luftimit të korrupsionit, që edhe nëse nuk mund t'ju përmbahemi të gjithave rregullave të paktën përmes disave prej tyre mund të arrihet një reduktim i dukshëm i korrupsionit dhe vendi do të arrijë të ketë një zhvillim më të mirë ekonomik dhe politik.

Ndërsa për sa i përket luftës kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut ka arritur një përparim të mirë përmes konsolidimit të mëtejshëm të procesverbalit në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve të nivelit të lartë të korrupsionit dhe përmes ndryshimeve në kornizën legjislative. Në këtë drejtim, korniza e re ligjore për parandalimin e korrupsionit është përmirësuar dhe emërimi i anëtarëve të rinj të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka qenë shumë më transparent se në vitet e kaluara. Komisioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të luftuar në mënyrë proaktive kundër korrupsionit, duke përfshirë zyrtarë të nivelit të lartë në të gjithë spektrin politik. Por sidoqoftë, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe mbetet çështje shqetësuese.⁷¹

⁷¹ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/COUNTRY_19_2777

2. Problemet e zbulimit të korrupsionit

Matja e incidencës së çfarëdo llojë krimi ka tendencë të jetë problematike sepse krimi shpesh ndodh që të jetë i paraportuar. Krimet si vjedhjet dhe sulmet kanë viktime të drejtëpërdrejta dhe kriminologët mund që të përcaktojnë sasinë e këtyre krimeve me anë të disa aktiviteteve siç mund të jetë intervistimi i një numëri të madhë të popullatës dhe ashtu të mund të zbulojnë se cilëve krime u janë nënshtruar për një periudhë kohe të caktuar. Por kjo është shumë më e vështirë në rastin e korrupsionit., pasi që përkundër krimeve si vjedhjet dhe sulmet, korrupsioni nuk ka viktime të drejtëpërdrejta, por ajo përfshinë komunitetin e përgjithshëm që mbanë barrën e korrupsionit indirekt, përmes devijimit të fondeve nga të mirat dhe shërbimet publike. Pra korrupsioni shpesh kalon pa u vënë re. E gjitha kjo pasi që shumica e veprimtarive mashtruese apo korruptive tentojnë që të kryhen në fshehtësi, duke patur pak ose aspak dëshmitarë, prandaj dhe kështu kjo dukuri është më rënd që të raportohet pasi që nuk mund të raportohet diçka që nuk mund edhe të dëshmohet.⁷²

3. Bashkëpunimi rajonal në luftën kundër korrupsionit

Bashkëpunimi rajonal ka qenë një ndër arritjet më të mëdhaja të Ballkanit Perëndimor dhe me vete ka sjellë dy përfitime kryesore. Së pari, zvogëlon tensionin dhe forcon stabilitetin rajonal. Së dyti, sjellë përfitime të ndryshme praktike që rrjedhin nga nivele më të larta të flukseve brenda mallrave dhe shërbimeve rajonale, rritja e konkurrencës të ekonomive relativisht të vogla dhe atraktivitete të rritura tëi rajonit si një destinacion investimi.⁷³

Bashkëpunimi rajonal ka të bëjë me çështje të caktuara të sigurisë, sfidat, rreziqet dhe kërcënimet dhe për këtë arsye ka forma dhe aspekte të ndryshme. Secili rajon ka veçoritë e veta dhe rrethana që janë të rëndësishme për një kuptim më të mirë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Bashkëpunimi rajonal në luftimin e krimit është i domosdoshëm për mbijetesën e kombeve dhe shteteve, në funksion të paqes dhe të stabilitetit rajonal. Aktet më të rëndësishme të bashkëpunimit janë marrë në bazë të burimeve juridike, kryesisht Konventa për bashkëpunim ndërkombëtar policor në Evropën Juglindore (SEE) dhe Konventa e Qendrës së Zbatimit të Ligjit të Evropës Juglindore (SELEC).

⁷² Clare Fletcher & Daniela Herrmann "The internationalization of Corruption – Scale, impact and countermeasures", Britania, 2012, p. 17-18.

⁷³ Oleg Levitin & Peter Sanfey "Regional Cooperation in the Western Balkans", 2018, p. 1.

Rëndësi të madhe i është dhënë iniciativave, proceseve dhe mekanizmave rajonale të tilla si: Procesi i bashkëpunimit midis vendeve të Evropës Juglindore (CPSEE), Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore (SPSEE), Këshillin e bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe të tjerë.⁷⁴ Më poshtë do sqarojmë disa nga organizatat më të rëndësishme:

Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) është një organizatë rajonale ndërqeveritare, e cila merret vetëm me çështjet e antikorupsionit dhe të ndërtojë institucionet demokratike në vendet që janë në tranzicion dhe nuk kanë mekanizma mbrojtës, duke mbuluar nëntë shtetet anëtare: Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Serbia.⁷⁵

Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal (RCC) përqendrohet tek bashkëpunimi rajonal në Europën Juglindore (EJL) nëpërmjet një kuadri me pronësi dhe udhëheqje rajonale, i cili gjithashtu mbështet integrimin europian dhe atë euro-atlantik. RCC-ja përbehet nga 45 vende, organizata dhe institucione financiare ndërkombëtare.⁷⁶

Bashkëpunimi rajonal mund të thuhet që është i domosdoshëm pasi që korrupsioni është një dukuri që nuk është problem i vetëm një vendi por ai paraqet një problem të përgjithshëm, prandaj dhe ky bashkëpunim ka shumë rëndësi pasi vetëm nëpërmjet tij mund të bëhet luftimi efikas i këtyre dukurive negative në vend.

⁷⁴ Zeljko Nikac & Vanda Bozic "Interantional Cooperation of Southeast Europe in the Fight of Against Crime", International Scientific – Practical Conference, Ukraine, 2016, p. 436-437.

⁷⁵ Regional Anti-Corruption Initiative - <https://www.rai-see.org/about-us/>

⁷⁶ Këshilli për Bashkëpunim Rajonal – <https://www.rcc.int>

4. Korrniza juridiko ndërkombëtare e luftës kundër korrupsionit

Legjislacioni ndërkombëtarë kundër korrupsionit përfshinë konventat shumëpalëshe më të rëndësishmet të miratura në nivelet e Bashkimit Kombëtar (KB) dhe Këshillit të Evropës. **Konventa e KB kundër Korrupsionit** përcakton detyrimin e shteteve nënshkruese që të parashikojnë masat për antikorrupsion në legjislacionin e tyre kombëtar, mekanizmat adekuat ligjorë dhe institucionalë për luftimin e korrupsionit, trajnimi i stafit dhe inkriminimi i veprave penale korruptive në ligjin kombëtar. Ndër inkriminimet më të rëndësishme përmenden: miti, përvetësim i paligjeshëm, tregti me ndikim, shpërdorim i detyrës, angazhim i paligjshëm, pastrim parash i pasurive të fituara nga një vepër penale, pengimi i drejtësisë, përgjegjësia e personave juridikë dhe ndëshkimi i të gjithë personave që kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale.⁷⁷

Bankat Ndërkombëtare të Zhvillimit ashtu si: Banka Botrore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar gjithashtu janë bërë aktive në fushën kundër mashtrimit dhe korrupsionit. Banka Botërore është në pronësi të 185 vendeve anëtare dhe përfshinë dy institucione zhvillimi – Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA). Objektivi i saj kryesor është që të ofrojë ndihmë financiare dhe teknike për vendet në zhvillim. Këto dy institucione ofrojnë kredi me interes të ulët, kredi pa interes dhe grante për zhvillimin e arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës, komunikimeve dhe qëllime të tjera. Ndërsa Fondi Monetar Ndërkombëtar gjithashtu ka 185 shtete anëtare dhe është krijuar për të promovuar bashkërendimin monetar ndërkombëtar, për të zhvendosur stabilitetin dhe marrëveshjet e rregullta të shërbimit. Për të nxitur rritjen ekonomike dhe nivele të larta të punësimit.⁷⁸

Konventa e Ligjit Penal për korrupsionin është një instrument ambicioz që synon të koordinojë kriminalizimin e një numri të madhë të praktikave korruptive. Ai gjithashtu ofron masa për të drejtën penale plotësuese dhe për të përmisuar bashkëpunimin ndërkombëtar në ndjekjen e veprave të korrupsionit. Konventa është e hapur për pranimin e shteteve jo anëtare. Zbatimi i tij do të monitorohet nga Grupi i shteteve kundër korrupsionit – GRECO, i cili filloi të funksionojë në 1 Maj 1999. Sapo ta ratifikojnë atë, shtetet që nuk i përkasin

⁷⁷ V. Bozic & Z. Nikac “Criminal Law framework to combat criminal offenses of corruption in Croatia and Serbia”, International Journal of Management Science and Business Administration, 6 (2), 2020, 19-23.

⁷⁸ Clare Fletcher & Daniela Herrmann “The internationalization of Corruption – Scale, impact and countermeasures”, Britania, 2012, p.67-68.

GRECO-s do të bëhen automatikisht anëtare. Kjo konventë përfshinë format e mëposhtme të sjelljes korruptive që zakonisht konsiderohen si lloje specifike të korrupsionit:⁷⁹

- Miti aktiv dhe pasiv të zyrtarëve publik vendas dhe të huaj;
- Miti aktiv dhe pasiv i parlamentarëve kombëtarë dhe të huaj dhe i anëtarëve të asambleve parlamentare ndërkombëtare;
- Miti aktiv dhe pasiv në sektorin privat;
- Miti aktiv dhe pasiv i nënpunësve civil ndërkombëtarë;
- Miti aktiv dhe pasiv i gjyqëtarëve vendas, të huaj dhe ndërkombëtarë dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare;
- Tregtimi aktiv dhe pasiv i ndikimit;
- Pastrimi i parave të të ardhurave nga veprat penale të korrupsionit;
- Veprat e kontabilitetit (faturat, dokumentet kontabël,etj) të lidhura me veprat e korrupsionit.

Shteteve u kërkohet të parashikojnë sanksione dhe masa efektive dhe shmangëse, përfshirë privimin e lirisë që mund të çojë në ekstradim. Personat juridik gjithashtu do të jenë përgjegjës për veprat penale të kryera në dobi të tyre dhe do t'i nënshtrohen sanksioneve efektive penale ose jo-penale, përfshirë sanksionet monetare. Konventa gjithashtu përfshinë dispozita në lidhje me ndihmën dhe aftësimin, imunitetin, kriteret për përcaktimin e juridiksionit të shteteve, përgjegjësinë e personave juridikë, krijimin e organeve të specializuara kundër korrupsionit, mbrojtjen e personave që bashkëpunojnë me autoritet hetuese ose ndjekëse, mledhjen e provave dhe konfiskimin e pasurisë. Ai parashikon një bashkëpunim të zgjeruar ndërkombëtar (ndihmë të ndërsjellë, ekstradim dhe siguri të informacionit) në hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të korrupsionit.

Konventa e Ligjit Civil është përpjekja e parë për të përcaktuar rregullat e zakonshme ndërkombëtare në fushën e ligjit civil dhe korrupsionit. Kjo Konventë përcaktonë korrupsionin si çdo veprim që ka të bëjë me direkt ose kërkim i tërthortë, ofrimi, dhënia ose marrja e mitit ose çfarëdo përdorimi tjetër i paautorizuar, si dhe aftësia për të marrë përfitime të tilla. Kjo kërkon nga Palët Kontraktuese të parashikojnë në ligjin e tyre të brendshëm “për mjete juridike efektive për personat që kanë pësuar dëmtime si rezultat i akteve të korrupsionit, për t’iu dhënë mundësi atyre të mbrojnë të drejtat dhe interesat e

⁷⁹ Criminal Law Convention on Corruption, COE, ETS No.173, 1999.

tyre, duke përfshirë mundësinë e marrjes së kompensimit për dëmin,,. Kjo Konventë është e ndarë në tre kapituj, ato përfshijnë: masat që duhen ndërmarrë në nivelin kombëtarë, bashkëpunimin ndërkombëtarë dhe monitorimin e zbatimit si dhe klauzolat përfundimtare. Në ratifikimin e Konventës, Shtetet marrin përsipër të përfshijnë parimet dhe rregullat e saj në ligjin e tyre të brendshëm, duke marrë parasyshrrethanat e tyre të veçanta.⁸⁰

Konventa e Kombeve të Bashkuar për Republikën e Maqedonisë së Veriut, tregon që në përputhje me nenin 6, paragrafin 3, autoritetet kompetente të RMV-së të cilat mund të ndihmojnë shtetet e tjera pjestare në zhvillimin dhe zbatimin e masave specifike për parandalimin e korrupsionit, janë: Komisioni Shtetëror për Shuarjen e Korrupsionit dhe Prokurorinë Publike për ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit.⁸¹

⁸⁰ Civil Law Convention on Corruption, COE, ETS No. 174, 1999.

⁸¹ Nations Covention Against Corruption - NCAC, UN Treaty Series, 2003, vol. 2349, 41; Doc. A/58/422

Përfundime dhe rekomandime

Si përfundim mund të themi që korrupsioni si fenomen ka prekur të gjitha vendet dhe ajo si dukuri është e pamundur që të eliminohet tërësisht por mund që të reduktohet deri në një farë mase që të arrihet një nivel që nuk është i dëmshëm as për vendin e as për shoqërinë. Reduktimi i korrupsionit mund të arrihet vetëm nëse merren masa korrigjuese me kohë ashtu që të gjitha institucionet private dhe ato publike të funksionojnë në mënyrë të rregullt dhe njëkohësisht edhe qytetarët të fitojnë besimin e tyre në institucione.

Nga të gjitha të dhënat e marra prej Transparency International vërejtëm që nga kjo dukuri janë të prekura të gjitha vendet, si vendet e zhvilluara ashtu edhe ato të pazhvilluara, por që me një nivel të lartë të korrupsionit karakterizohen vendet në zhvillim, veçanërisht vendet e Ballkanit Perëndimor. Se përse këto vende janë me nivel më të lartë mund të përmendim disa shkaqe të përbashkëta kryesore, siç janë: pagat e ulëta më shumë në sektorin publik por edhe në atë privat, papunësia e lartë, popullata e varfër, ofrim i vogël për vende pune, e kështu me rradhë. Por që përveç këtyre shkaqeve mund të themi që këto vende nuk e kanë shumë mirë të zhvilluar sistemin ligjorë dhe atë institucional dhe se agjensionet për të luftuar korrupsionin e vendit nuk funksionojnë si duhet.

Maqedonia e Veriut është një ndër vendet në zhvillim dhe kuptojmë që është edhe një ndër vendet më të prekura nga korrupsioni dhe duke shikuar të gjitha të dhënat e grumbulluara dhe analizat e kryera vërejtëm që në krahasim nga viti paraprak në vitin 2019 korrupsioni ka filluar të rritet, por edhe duke patur parasysh të gjitha rastet e ndryshme të përmendura në punim të cilat kanë ndodhur në vend, erdhëm në përfundim që korrupsioni është më së shumti i pranishëm tek prokuroria publike dhe për këtë arsye është vështirë që të luftohet kjo dukuri, pasi që duke patur parasysh se ajo kryhet nga autoritete të larta egzistojnë mundësia që të kryhen shumë manipulime në vend dhe është vështirë që të zbatohet ligji ashtu si duhet.

Për të luftuar korrupsionin Kodi Penal i RMV parasheh veprat penale kundër tij me dënime të caktuara, por që ato nuk mund të themi që janë të mjaftueshme pasi që ajo është një dukuri që vështirë mund të zhduket, prandaj dhe një rol të rëndësishëm për të luftuar atë kanë gjykatat dhe prokuroria publike, ku në qoftëse ato funksionojnë në mënyrë të duhur atëherë mund të kemi një reduktim të dukshëm të kësaj dukurie, gjithashtu dhe një rol tjetër kryesor luan edhe Agjensionin kundër Korrupsionit i cili vazhdimisht është duke u

përpjekur që të e parandalojë këtë dukuri dhe nga të gjitha përpjekjet e bëra në përgjithësi ai jep rezultate të dukshme dhe të favorshme. Të gjitha institucionet e lartëpërmendura duhet që në mënyrë të vazhdueshme dhe në mënyrën e duhur të marrin masat e nevojshme të cilat do të na dërgojnë deri tek reduktimi i korrupsionit ashtu që të arrihet një shkallë e ulët që nuk do jetë në dëm as të shtetit as të shoqërisë në tërësi. Si masa kryesore që duhet të ndërmerren janë: masat legjislative, ato organizative dhe një bashkëpunim i mirë rajonal dhe ndërkombëtar ndërmjet vendeve.

Rekomandimet

Rezultatet tona shfaqin rëndësi të madhe për shoqërinë dhe për të gjitha institucionet qofshin ato private apo publike, pasi që nëse ato dëshirojnë që të eliminojnë korrupsionin në kompanitë e tyre, të e reduktojnë shkallën e tij në vend duhet që të analizojnë mirë të gjithë faktorët të cilët çojnë në korrupsion. Për një të ardhme më të mirë të vendit duhet që të bëhen analiza të hollësishme si: zbulimi i faktorëve kryesor dhe më pas duke zbuluar se ku është korrupsioni më prezent, cilët profesione janë më të prekura nga kjo dukuri dhe ashtu të merren të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të mos ndikojë ajo në përparimin e shtetit, në demokracinë dhe në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror të vendit. Prandaj ne rekomandojmë që korrupsioni mund të parandalohet apo mund të reduktohet deri në një shkallë të favorshme, vetëm nëse institucionet përkatëse si: gjykatat, prokuroria publike dhe institucionet tjera kompetente shtetërore reagojnë me kohë duke qenë më efikase në luftimin e korrupsionit, me përdorimin e masave të nevojshme të cilat kanë efekt të madhë gjatë aplikimit të tyre, siç edhe mund të jetë: ashpërsimi i politikës ndëshkimore ndaj atyre që kryejnë vepra penale, të ketë një rritje të efikasitetit dhe përgjegjësisë së organeve gjatë zbulimit dhe hetimit të këtyre veprave, e kështu me rradhë.

Kufizimet e punimit dhe sugjerimet për të ardhmen

Ky studim ka kufizimet e veta duke patur parasysh numrin e vendeve dhe periudhën që kemi analizuar, pasi që periudha e analizuar është e vogël dhe punimi më shumë është i përqendruar në vendet e rajonit apo ato të Ballkanit Perëndimor, e veçanërisht për Maqedoninë e Veriut. Nëse studimi jonë do të kishte përfshirë të gjitha vendet e Bashkimit Evropian apo të gjitha vendet e botës me siguri që rezultatet tona do të ndryshonin, pasi që bëhet fjalë për një mostër shumë më të madhë ku dihet që ka vende që janë edhe me keq

apo edhe më mirë në lidhje me shkallën e korrupsionit, por që kuptohet ajo kërkon shumë kohë dhe shumë të dhëna për të cilat edhe do të kishim vështirësi për t'i gjetur.

Sugjerimi për të ardhmen do të ishte që analiza jonë të fokusohet në rritjen e numrit të vendeve, të përfshijmë vende tjera përpos vendeve të rajonit, të analizohet një periudhë më e gjatë dhe ashtu të mund të shohim se si është niveli i korrupsionit në vendet tjera dhe çfarë masash ndërmarrin ato për të reduktuar këtë dukuri dhe të njëjtat a janë të vlefshme në përdorim dhe të përshtatshme për ato vende dhe për vendin tonë.

Referencat

- Ardita Abduli & Drita Mehmedi. (2018). White Collar Crime in Republic of Macedonia in the Period 2008-2017. *European Journal of Social Sciences* , 1 (3), 178-184.
- Balkan WEB . (n.d.). Retrieved from <http://www.balkanweb.com/shifrat-shqiperia-zhytet-ne-korrupsion-zbret-me-8-vende/>
- Bozic, Z. N. (2016). International Cooperation of SouthEast Europe in the Fight Against Crime. *International Scientific - Practical Conference* , (pp. 431-459). Ukraine .
- Cain, A. J. (2010). "Corruption". In R. Hughes, *Passage of Change: Law, Society and Governance in the Public* (pp. 35-50). Canberra.
- Danilet, C. (2011). *Korrupsioni dhe Antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë*. Tiranë.
- Fletcher, C., & Hermann, D. (2012). *The Internationalisation of Corription: Scale, Impact and Countermeasures*. Britania.
- G.Vula, D. V. (2013). *Kriminaliteti i organizuar*. Prishtina.
- Georgievski, S. (2014). Application of the Law of the European Union in the Republic of Macedonia. Centre for Seels.
- Georgievski, S. (2012). European Union Law Application in the Republic of Macedonia Before its Accession to the EU. Skopje: Universiteti Kirili dhe Metodi .
- Gjonça, L. (2004). *Korrupsioni - Veprat penale përbërëse, Krimi i Organizuar*. Tiranë.
- Gorta, A. (2013). Research: A tool for building Corruption Resistance. In *Corruption and Anti-corruption* (p. 13).
- Grigorev, L., & Ovchinnikov, M. (2009). Corruption as an Obstacle to Modernization. *Problem Of Economic Transition* , 51 (11), 40-61.
- Halili, D. R. (2011). *Kriminologjia*. Prishtina.
- Hughes, R. (2010). Corruption. In *Passage of Changes: Law, Society and Governance* (pp. 35-50). Canberra : ANU Press.
- Kapo, M. (2017). *Veprat penale në administratën publike, aspekte doktrinale dhe politike në legjislacionin Shqiptar*. Tiranë.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës* . (n.d.).
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*. (n.d.).
- La Corrupcion - Caracteristicas y consecuencias en Republica Dominicana. (2003). *Programa de Transparencia de la Gestion Publica* (p. 5). Participacion Ciudadana.
- Lascoumes, P. (2002). *Korrupsioni*. Francë.
- Murati, V., & Berisha, Q. (2010). *Politikat sociale në Kosovë: skemat sociale dhe përshtatshmëria e tyre me realitetin Kosovar*. Prishtinë.
- Rade Bogojevic & Tatjana Skakavac. (2018). Corruption as an obstacle to European Integrations. *Facta Universitatis, Series: Law and Politics* , 16, 57-67.
- Rose, J. (2018). The Meaning of Corruption: Testing the Coherence and Adequacy of Corruption Definitions. *Public Integrity* , 20 (3), 220-233.
- Sanfey, O. L. (2018). *Regional Cooperation in the Western Balkans*.

- Shehu, S. (2017). *Korrupsioni - Këndvështrim shoqëror, kriminologjik dhe penal*. Tiranë.
- Tatjana Petrushevska; Saso Georgievski; Natasha Stamenkovikj; Mihail Stojanovski & Ilina Cenevska. (2012). *European Union Law Application in the Republic of Macedonia before its Accession to the EU*. Skopje.
- V. Bozic & Z. Nikac. (2010). Criminal Law framework to combat criminal offenses of corruption in Croatia and Serbia. *International Journal of Management Science and Business Administration*, 6 (2), 19-23.
- Vllado Kambovski; Ismail Zejneli; Nenad Jançeviç; Vesel Latifi; Zoran Sulejmanov; Bistra Netkova. (2009). *Kriminaliteti i organizuar - aspekte juridike*. Tetovë: South East European University.
- Wolanin, P. L. (2013). Research: A tool for building corruption resistance. In A. Gorta, *Corruption and Anti-corruption* (pp. 11-29). ANU Press.
- Zejneli, I. (2014). Corruption as a form of Organized Crime. *International Journal of Humanities and Social Science*, 103.
- Zejneli, I. (2007). *E drejta Penale - pjesa e posaçme*. Tetovë.
- Салоски, Ш. (2014, август). *Криминалитет на Белите Јаки*. Retrieved from Правдико мк: <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2014/08/statija1.pdf>

Adresat në internet – Linqet:

- Civil Law Convention on Corruption COE ETS N.174*. (1999). Retrieved from Council of Europe Portal : <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/174>
- Corruption in the Western Balkans 2019: Trends and Policy Options*. (2019). Retrieved from SELDI: https://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/Policy_Brief_9/SELDI_PB_09_Corruption_in_the_Western_Balkans_2019.pdf
- Criminal Law Convention on Corruption COE ETS N.173*. (1999). Retrieved from Council of Europe Portal: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/173>
- Kodi Penal i RMV*. (n.d.). Retrieved from <http://www.akademika.com.mk>
- Këshilli Për Bashkëpunim Rajonal*. (n.d.). Retrieved from <https://www.rcc.int>
- Regional Anti-Corruption Initiative*. (n.d.). Retrieved from <https://www.rai-see.org/about-us/>
- Sociological Theories and Corruption Sociology Essay*. (2018). Retrieved from <https://www.ukessays.com/essays/sociology/sociological-theories-and-corruption-sociology-essay.php>
- The Law Dictionary*. (n.d.). Retrieved from Black Law: <http://www.thelawdictionary.org/corruption/>
- Trading Economics*. (n.d.). Retrieved from <http://tradingeconomics.com/>
- Transparency International*. (n.d.). Retrieved from <https://www.transparency.org>
- United Nations Convention against Corruption, UN Treaty Series, vol.2349*. (2003). Retrieved from https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-14&chapter=18&clang=_en
- <http://kosova-sot.info/lajme/269607//>
- <http://euronews.al/al/macedonia-e-veriut/2020/01/23/korrupsioni-ne-maqedonine-e-veriut-humbet-13-vende-ne-krahasim-me-vitin-e-kaluar>

<http://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/krivicen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>

<https://portalb.mk/384658-larje-parash-ne-maqedoni-tabela-treqind-total-dhe-tifani-rastet-e-reja-te-psp-se-video/>

<https://zaman.mk/al/aktuale/11885-gjykata-e-apelit-vendos-per-bombat-si-argumente-ne-rastin-tank.html>

<https://portalb.mk/569351-rasti-perandoria-biznesmeni-orce-kamcev-u-dergua-ne-gjykate-videoarrestimi-i-biznesmenit-orce-kamcev-nga-psp-thone-se-ende-jane-ne-proces/>

<https://portalb.mk/634551-na-ishte-nje-here/>

<https://portalb.mk/681890-rasti-zhvatja-janeva-ka-paditur-boki-13-te-per-incizim-te-paautorizuar/>

http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat__Sudstvo/100_SK_ml_T-1.px/table/tableViewLayout2/?rxid=41dd7f7d-a7c5-4219-ba3b-cb448a775850

http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat__Sudstvo/100_SK_ml_T-1.px/table/tableViewLayout2/?rxid=1727abf2-5f75-40d7-b2da-905bd124e744

<https://mcms.mk/images/docs/2020/izveshtaj-za-procena-na-korupcijata-vo-severna-makedonija-2020.pdf>

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/COUNTRY_19_2777

Shtojcat

Shtojca 1 Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2019: Rezultati Global

Country	ISO3	Region	CPI score 2019	Rank
Denmark	DNK	WE/EU	87	1
New Zealand	NZL	AP	87	1
Finland	FIN	WE/EU	86	3
Singapore	SGP	AP	85	4
Sweden	SWE	WE/EU	85	4
Switzerland	CHE	WE/EU	85	4
Norway	NOR	WE/EU	84	7
Netherlands	NLD	WE/EU	82	8
Germany	DEU	WE/EU	80	9
Luxembourg	LUX	WE/EU	80	9
Iceland	ISL	WE/EU	78	11
Australia	AUS	AP	77	12
Austria	AUT	WE/EU	77	12
Canada	CAN	AME	77	12
United Kingdom	GBR	WE/EU	77	12
Hong Kong	HKG	AP	76	16
Belgium	BEL	WE/EU	75	17
Estonia	EST	WE/EU	74	18
Ireland	IRL	WE/EU	74	18
Japan	JPN	AP	73	20
United Arab Emirates	ARE	MENA	71	21
Uruguay	URY	AME	71	21
France	FRA	WE/EU	69	23
United States of America	USA	AME	69	23
Bhutan	BTN	AP	68	25
Chile	CHL	AME	67	26
Seychelles	SYC	SSA	66	27
Taiwan	TWN	AP	65	28
Bahamas	BHS	AME	64	29
Barbados	BRB	AME	62	30
Portugal	PRT	WE/EU	62	30
Qatar	QAT	MENA	62	30
Spain	ESP	WE/EU	62	30
Botswana	BWA	SSA	61	34
Brunei Darussalam	BRN	AP	60	35
Israel	ISR	MENA	60	35
Lithuania	LTU	WE/EU	60	35
Slovenia	SVN	WE/EU	60	35

Korea, South	KOR	AP	59	39
Saint Vincent and the Grenadines	VCT	AME	59	39
Cabo Verde	CPV	SSA	58	41
Cyprus	CYP	WE/EU	58	41
Poland	POL	WE/EU	58	41
Costa Rica	CRI	AME	56	44
Czech Republic	CZE	WE/EU	56	44
Georgia	GEO	ECA	56	44
Latvia	LVA	WE/EU	56	44
Dominica	DMA	AME	55	48
Saint Lucia	LCA	AME	55	48
Malta	MLT	WE/EU	54	50
Grenada	GRD	AME	53	51
Italy	ITA	WE/EU	53	51
Malaysia	MYS	AP	53	51
Rwanda	RWA	SSA	53	51
Saudi Arabia	SAU	MENA	53	51
Mauritius	MUS	SSA	52	56
Namibia	NAM	SSA	52	56
Oman	OMN	MENA	52	56
Slovakia	SVK	WE/EU	50	59
Cuba	CUB	AME	48	60
Greece	GRC	WE/EU	48	60
Jordan	JOR	MENA	48	60
Croatia	HRV	WE/EU	47	63
Sao Tome and Principe	STP	SSA	46	64
Vanuatu	VUT	AP	46	64
Argentina	ARG	AME	45	66
Belarus	BLR	ECA	45	66
Montenegro	MNE	ECA	45	66
Senegal	SEN	SSA	45	66
Hungary	HUN	WE/EU	44	70
Romania	ROU	WE/EU	44	70
South Africa	ZAF	SSA	44	70
Suriname	SUR	AME	44	70
Bulgaria	BGR	WE/EU	43	74
Jamaica	JAM	AME	43	74
Tunisia	TUN	MENA	43	74
Armenia	ARM	ECA	42	77
Bahrain	BHR	MENA	42	77
Solomon Islands	SLB	AP	42	77
Benin	BEN	SSA	41	80
China	CHN	AP	41	80
Ghana	GHA	SSA	41	80

India	IND	AP	41	80
Morocco	MAR	MENA	41	80
Burkina Faso	BFA	SSA	40	85
Guyana	GUY	AME	40	85
Indonesia	IDN	AP	40	85
Kuwait	KWT	MENA	40	85
Lesotho	LSO	SSA	40	85
Trinidad and Tobago	TTO	AME	40	85
Serbia	SRB	ECA	39	91
Turkey	TUR	ECA	39	91
Ecuador	ECU	AME	38	93
Sri Lanka	LKA	AP	38	93
Timor-Leste	TLS	AP	38	93
Colombia	COL	AME	37	96
Ethiopia	ETH	SSA	37	96
Gambia	GMB	SSA	37	96
Tanzania	TZA	SSA	37	96
Vietnam	VNM	AP	37	96
Bosnia and Herzegovina	BIH	ECA	36	101
Kosovo	KSV	ECA	36	101
Panama	PAN	AME	36	101
Peru	PER	AME	36	101
Thailand	THA	AP	36	101
Albania	ALB	ECA	35	106
Algeria	DZA	MENA	35	106
Brazil	BRA	AME	35	106
Cote d'Ivoire	CIV	SSA	35	106
Egypt	EGY	MENA	35	106
North Macedonia	MKD	ECA	35	106
Mongolia	MNG	AP	35	106
El Salvador	SLV	AME	34	113
Kazakhstan	KAZ	ECA	34	113
Nepal	NPL	AP	34	113
Philippines	PHL	AP	34	113
Eswatini	SWZ	SSA	34	113
Zambia	ZMB	SSA	34	113
Sierra Leone	SLE	SSA	33	119
Moldova	MDA	ECA	32	120
Niger	NER	SSA	32	120
Pakistan	PAK	AP	32	120
Bolivia	BOL	AME	31	123
Gabon	GAB	SSA	31	123
Malawi	MWI	SSA	31	123
Azerbaijan	AZE	ECA	30	126

Djibouti	DJI	SSA	30	126
Kyrgyzstan	KGZ	ECA	30	126
Ukraine	UKR	ECA	30	126
Guinea	GIN	SSA	29	130
Laos	LAO	AP	29	130
Maldives	MDV	AP	29	130
Mali	MLI	SSA	29	130
Mexico	MEX	AME	29	130
Myanmar	MMR	AP	29	130
Togo	TGO	SSA	29	130
Dominican Republic	DOM	AME	28	137
Kenya	KEN	SSA	28	137
Lebanon	LBN	MENA	28	137
Liberia	LBR	SSA	28	137
Mauritania	MRT	SSA	28	137
Papua New Guinea	PNG	AP	28	137
Paraguay	PRY	AME	28	137
Russia	RUS	ECA	28	137
Uganda	UGA	SSA	28	137
Angola	AGO	SSA	26	146
Bangladesh	BGD	AP	26	146
Guatemala	GTM	AME	26	146
Honduras	HND	AME	26	146
Iran	IRN	MENA	26	146
Mozambique	MOZ	SSA	26	146
Nigeria	NGA	SSA	26	146
Cameroon	CMR	SSA	25	153
Central African Republic	CAF	SSA	25	153
Comoros	COM	SSA	25	153
Tajikistan	TJK	ECA	25	153
Uzbekistan	UZB	ECA	25	153
Madagascar	MDG	SSA	24	158
Zimbabwe	ZWE	SSA	24	158
Eritrea	ERI	SSA	23	160
Nicaragua	NIC	AME	22	161
Cambodia	KHM	AP	20	162
Chad	TCD	SSA	20	162
Iraq	IRQ	MENA	20	162
Burundi	BDI	SSA	19	165
Congo	COG	SSA	19	165
Turkmenistan	TKM	ECA	19	165
Democratic Republic of the Congo	COD	SSA	18	168
Guinea Bissau	GNB	SSA	18	168
Haiti	HTI	AME	18	168

Libya	LBY	MENA	18	168
Korea, North	PRK	AP	17	172
Afghanistan	AFG	AP	16	173
Equatorial Guinea	GNQ	SSA	16	173
Sudan	SDN	SSA	16	173
Venezuela	VEN	AME	16	173
Yemen	YEM	MENA	15	177
Syria	SYR	MENA	13	178
South Sudan	SSD	SSA	12	179
Somalia	SOM	SSA	9	180

**Shtojca 2 Numri i personave të shpallur fajtor për kryerjen e të gjitha llojeve të krimeve
për periudhën 2010-2019**

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
krime kundër jetës dhe trupit	872	945	881	920	924	790	761	664	659	648
krime kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarëve	217	240	223	283	301	272	272	234	219	283
krime kundër nderit dhe reputacionit	179	169	141	18	1	1	-	1	-	-
krime kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual	54	54	47	64	49	56	39	38	44	23
krime kundër martesës, familjes dhe rinis	272	317	305	304	275	308	301	252	215	200
krime kundër financave publike, operacionet e pagesës dhe ekonomisë	293	240	212	255	277	277	261	177	119	121
krime kundër pronës	3612	3850	3652	4073	3965	4296	3370	2427	2339	1984
Krime kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronave	100	126	125	138	117	126	98	83	81	91
krime kundër sigurisë në komunikacion	1764	1770	1595	1670	1708	1432	1322	1165	975	815
krime kundër shtetit	1	-	1	4	2	10	14	18	-	6
krime kundër forcave të armatosura	4	7	4	4	8	8	2	2	2	-
krime kundër detyrës zyrtare	142	133	150	137	243	201	113	96	92	87
krime kundër transaksioneve legale	481	477	372	285	1990	858	244	154	154	119
krime kundër rendit publik	535	665	601	622	931	821	653	401	483	447
krime tjera	566	773	713	742	860	834	634	539	460	535
krime të parashikuara nga ligje të tjera	77	44	20	20	32	22	39	22	15	11